



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 20.09.2016, ora 13:00

**Drejton mbledhjen:**

**Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbaleve te komisionit.
2. Vazhdim i diskutimit rreth projektligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”

**Marrin pjesë:**

Fatmir Xhafaj, Pandeli Majko, Vasilika Hysi, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Vexhi Muçmataj.

**Mungojnë:**

Spartak Braho, Oerd Bylykbashi, Keltis Kruja, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu.

**Të ftuar:**

Gent Ibrahimimi – Ekspert i Nivelit të Lartë

Agnes Bernhard - Eksperte e Nivelit të Lartë

## HAPET MBLEDHJA

**Fatmir Xhafaj** – Fillojmë shqyrtimin e projektligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë.”

Fillimisht duhet të miratojmë procesverbalet e komisionit. Sekretarja i ka bërë gati.

Dakord.

Vazhdojmë me nenin 36. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga trupa e pedagogëve të drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës.

Zonja Hysi, urdhëroni!

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Ky nënseksion është bashkimi i dy nënseksioneve, sepse në projektin e depozituar fillimisht në komision, zgjedhja e trupës së pedagogëve ka qenë e shkëputur nga zgjedhja e trupës së Shkollës së Magjistraturës.

Ndryshimi kushtetues, konkretisht neni 147 i Kushtetutës, paragrafi 4 përdoret togfjalëshi “së bashku pedagogët e drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës”, detyroi të fshihet një nga këto nënçështjet dhe të bashkohet.

Lidhur me nenin 36, janë reflektuar ndryshimet kushtetuese. Është plotësuar përvoja, kërkesa që ka Kushtetuta, pra, jo më pak se 15 vjet jurist.

Njëkohësisht, për të shmangur konfliktin e interesit është shtuar që në kohën e kandidimit, kandidati nuk mund të jetë rektor, dekan, drejtor i Shkollës së Magjistraturës, organ ose anëtar i organeve drejtuese, të grupeve të interesit, siç janë: sindikatat, shoqatat e gjyqtarëve.

Janë plotësuar edhe kriteret e tjera të kërkuara për të mos qenë bashkëpunëtor ose i favorizuar nga shërbimet e inteligjencës sot ose edhe më parë, si dhe në kohën e kandidimit të mos ketë qenë asnjë anëtar i familjes sipas kuptimit të ligjit “Për deklarimin, kontrollin e pasurive dhe konflikteve të interesit” në shkallë të parë, anëtar në detyrën e këshillit ose kandidat.

Gjithashtu, janë plotësuar kriteret se kush ka të drejtë të përzgjidhet. Për Shkollën e Magjistraturës përzgjedhin më shumë se dy kandidatë nga radhët e pedagogëve me kohë të plotë dhe plotësimet e tjera janë të teknikës legjislative.

**Fatmir Xhafaj** – Ka gjë tjetër për të shtuar?

Dakord.

Me sa kuptoj unë, këtu janë përjashtuar nga kandidimi drejtori i Shkollës së Magjistraturës dhe rektorët, dekanët.

Dakord me nenin 36 bashkë me ndryshimet.

Neni 37. Thirrja për paraqitjen e shprehjes së interesit.

**Vasilika Hysi** – Kjo është rregulluar në përputhje me kërkesat. Ka vetëm saktësime, të cilat kanë të bëjnë me afatin se kur duhet bërë shpallja e vendit vakant.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 38.

**Vasilika Hysi** – Në nenin 38 kemi respektuar një sugjerim të zotit Vasili, lidhur me rastet kur shpallja e njoftimit të shprehjes së interesit brenda afatit nga drejtori i Shkollës së Magjistraturës ose nga rektori, në këtë rast, ka një mekanizëm zhbllokimi, që mund ta bëjmë në faqen e Ministrisë së Drejtësisë. Pra, në këtë rast ndryshimi bëhet në vend “që të shpallet nga Ministria e Arsimit, të bëhet “në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë”. Kjo ka një logjikë, pasi po bëhet fjalë për zgjedhjen e anëtarëve për qeverisjen e sistemit gjyqësor. Pjesa tjetër është sikurse ka qenë.

**Fatmir Xhafaj** – Domethënë, deri tani njoftimin e bënte ministri përgjegjës i Arsimit, tani do ta bëjë ministri i Drejtësisë.

Dakord.

Neni 39.

**Vasilika Hysi** – Në nenin 39 është reflektuar një sugjerim që kam bërë si relatore në këtë komision. Është po ai tekst, por kemi thënë që kopjes së kërkesës i duhet bashkëngjitur edhe dokumentacioni shoqërues. Kjo duhet të jetë e shprehur në ligj.

Gjithashtu, në paragrafin 3 kemi shtuar edhe një kriter tjetër: “ Kandidati që do të kandidojë duhet të përmbushë kriteret e ligjit për pastërtinë e figurave”.

Prandaj në nenin c kemi shtuar plotësimin e formularit të vetëdeklarimit lidhur me ligjin “ Për integritetin”, kriter që është futur edhe në nenet e tjera.

**Fatmir Xhafaj** – Edhe afati këtu është bërë nga 10 ditë në 15 ditë, apo jo?

**Vasilika Hysi** – Po. Në përgjithësi ekspertët i kanë riparë afatet, zoti kryetar, për t'i dhënë mundësi përgatitjes së dokumentacionit.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 40.

**Vasilika Hysi** - Në nenin 40 grupi i ekspertëve ka reflektuar ato komente dhe sugjerime që ne kemi bërë në mbledhjet e komisionit. Konkretisht, përveç ndryshimeve në referenca, për shkak të lëvizjes së numrave të ligjit janë përcaktuar edhe rregullat lidhur me përzgjedhjen e kandidatëve.

Njëkohësisht, në nenin 8, po ta shikoni, janë pothuajse përcaktuar përgjegjësitë. Pra, kush i ushtron përgjegjësitë në rastin e zgjedhjes së anëtarit nga Shkolla e Magjistraturës?

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 41.

**Vasilika Hysi** – Në nenin 41 kemi një saktësim, një shtim të periudhës se kur duhet të njoftohen për vakancën e krijuar. Nga 60 ditë është bërë nga 80 ditë përpara se të mbarojë afati i mandatit të anëtarit, pedagog në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Njëkohësisht, meqenëse është bashkuar thirrja për profesorët e fakulteteve të drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës në nenin 7 të mos përsëriten rregullat. Thuhet “që për ato rregulla, që përdoren për përzgjedhjen e kandidatëve në fakultete ose në departamente të drejtësisë, vlejnë edhe për zgjedhjen e anëtarit që do të vijë nga Shkolla e Magjistraturës”.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 41.

**Vasilika Hysi** – Në nenin 41 është “kuorumi” që ne e kemi diskutuar disa herë kur zgjidhen përfaqësuesit e trupave që do të përfaqësojnë anëtarët gjyqtarë në KLGJ dhe KLP. Është riformuluar paragrafi i parë.

**Fatmir Xhafaj** – Mos është “ankimet” te neni 41.

**Vasilika Hysi** – Jo, unë kam “kuorumi”.

**Fatmir Xhafaj** – Jo, jo, është “ankim”.

**Vasilika Hysi** – Atëherë, është shtuar një nen “kuorumi”, i cili duhet të jetë pjesëmarrja në mbledhjen e asamblesë së personelit akademik ose këshillit drejtues të Shkollës së Magjistraturës. E para.

E dyta, meqenëse kjo është një dispozitë që është përmendur edhe në nene të tjera: “Voton e gjithë mbledhja e asamblesë së personelit akademik ose Shkollës së Magjistraturës”.

Gjithashtu, sugjeroj që duhet shtuar një paragraf i tretë, ku të thuhet “të ketë një listë të pjesëmarrësve që marrin votim, të cilët duhet të firmosin”. Pra, këtë paragraf që e kemi standard në të gjitha nenet që bën fjalë për kuorumin. Ankimimet nuk kanë gjë.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 42. Përzgjedhja.

**Vasilika Hysi** – E thamë që ka të njëjtat kritere, nga 60 ditë është bërë 80 ditë. Në paragrafin 7 është shtuar një paragraf te përzgjedhja e kandidatëve që vijnë nga Shkolla e Magjistraturës. Të njëjtat rregulla që përdoren për zgjedhjen e kandidatëve nga fakulteti ose departamenti i drejtësisë përdoren edhe për zgjedhjen e kandidatëve nga Shkolla e Magjistraturës. Pra që të mos përsëriten rregullat në mënyrë të detajuar, është shtuar paragrafi 7.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 43. Kuorumi.

**Vasilika Hysi** – Është kuorumi, të cilin e diskutuam. Pra, kërkoj të shtohet një paragraf i tretë ku të thuhet “të jetë edhe lista e atyre që marrin pjesë në përzgjedhje”.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 44.

**Vasilika Hysi** – Në nenin 44 është po ai nen që kemi diskutuar. Ka disa ndryshime.

E para, është një saktësim bazuar në propozimin e zotit Vasili. Në paragrafin 4 shtohet “ministri i Drejtësisë, i cili ka të drejtë të marrë pjesë si vëzhgues në mbledhjet e asamblesë së personelit akademik për përzgjedhjen e kandidatëve”.

Njëkohësisht, është shtuar një paragraf i 8-të dhe i 9-të. Në paragrafin 8 parashikohet që procesi i votimit të jetë i njëjtë. Pra, të njëjtat rregulla që zbatohen për përzgjedhjen e anëtarëve, që vijnë nga trupa gjyqësore e Fakultetit të Drejtësisë dhe departamenteve të drejtësisë, do të zbatohet edhe për përzgjedhjen e trupave që do të bëhen nga Shkolla e Magjistraturës.

Gjithashtu, në paragrafin 9 kemi shtuar që përveç përfaqësuesit të autorizuar të Kuvendit, edhe ministri i Drejtësisë ka të drejtë të marrë pjesë vetë ose nëpërmjet përfaqësuesve të tij si vëzhgues në mbledhjen e këshillit drejtues për përzgjedhjen e kandidatëve të Shkollës së Magjistraturës pa pasur autorizim paraprak.

Dua të sjell në vëmendjen tuaj, se ju sollët një formulim tjetër, i cili m’u duk me interes, zoti kryetar. Mund ta mbajmë standard.

**Fatmir Xhafaj** – Po. Dakord.

Hiqeni këtë Këshilli i Lartë Gjyqësor. Pse do të marrë pjesë Këshilli i Lartë Gjyqësor?

Dakord.

Neni 45.

**Vasilika Hysi** – Në nenin 45 ka një reflektim të paragrafit 3. Është qartësuar se cilat janë votat e pavlefshme. Njëkohësisht, ka shtesa dhe përmirësime në paragrafin 6 dhe 7 të këtij ligji, ku përcaktohet qartë se çfarë do të tregojnë procesverbalet origjinale, që hartohen në mbledhjen e asamblesë së personelit akademikë ose të këshillit drejtues. Njëkohësisht edhe se çfarë përmban vendimi me rezultatet e zgjedhjes së shpalljes së fituesve, ku njoftohen ata. Pra, njoftimi publik që bëhet në përfundim.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 46.

**Vasilika Hysi** – Neni 46, për shkak të bashkimit, sikurse e thashë në fillim, të zgjedhjes nga trupa pedagogjike e këshillit është riformuluar titulli, duke shtuar “edhe këshilli drejtues” .

Njëkohësisht, ka një ndryshim në paragrafin e dytë duke përcaktuar të drejtën e rektorit të institutit të arsimit të lartë për të vendosur përsëritjen e zgjedhjeve në qoftë se ka shkelje procedurale.

Njëkohësisht, rregulli standard në paragrafin e 4 që rregullat afatet e parashikuara për ankimimet kundër vendimit të asamblesë së personelit akademik vlejné po të njëjtat rregulla edhe për këshillin drejtues të Shkollës së Magjistraturës.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 47.

**Vasilika Hysi** – Nuk ka ndryshime. Vetëm një saktësim të referencës në paragrafin e parë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 48.

**Vasilika Hysi** – Në nenin 48 ka disa riformulime bazuar në ndryshimet Kushtetuese. Ka saktësime në bazë të ndryshimeve që janë bërë nga Kushtetuta. Nuk ka gjë tjetër.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 49.

**Vasilika Hysi** – Është dispozitë standarde kuorumi. Është shtuar pika 3 ku thuhet: “për numrin e pjesëmarrësve në mbledhjen e posaçme shënohet një listë emërore e nënshkruar nga të gjithë të pranishmit”. Propozohet të shtohet kjo gjë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 50.

**Vasilika Hysi** – Procesi i votimit. Këtu ka disa reflektime të vogla. Janë redaktime kryesisht në paragrafët 6 dhe 7.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 51.

**Vasilika Hysi** – Është numërimi i votave dhe shpallja e rezultatit. Është saktësuar pjesa tretë se cilat janë fletët e pavlefshme dhe redaktime të vogla në paragrafët 4, 5, 6 dhe 7.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 52.

**Vasilika Hysi** – Në paragrafin e parë është shtuar “afati i të drejtës së ankimimit nga 3 në 5 ditë”.

Njëkohësisht, sugjeroj që në nenin 2, në paragrafin e dytë të këtij neni të saktësohet se për çfarë mund të vendosë gjykata. Pra, gjykata mund të vendosë përsëritjen e mbledhjes së posaçme vetëm në qoftë se shkeljet procedurale dhe të parashikuara në pikën e parë të këtij neni vërtetohen se janë të tilla që mund të kenë ndikuar ose do të kishin ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve. Pastaj paragrafi i 3 ka saktësime.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 53.

**Vasilika Hysi** – Neni 53 reflekton ndryshimet kushtetuese. Është pothuajse i rregulluar. Këtu duhet bërë një saktësim në paragrafin e dytë: “Kushtetuta kërkon jo më vonë se 2 ditë, por 3 ditë.

Njëkohësisht, sugjeroj që duhet shtuar “në lidhje me rastet kur mbaron mandati i një anëtari jogjyqtar para kohe”.

Pra, zoti kryetar, në projekt nuk parashikohej dot nëse një nga anëtarët jogjyqtar i mbaron mandati para kohe. Sugjeroj që kjo të rregullohet në një paragraf më vete. Ekspertët kanë sugjerime për të plotësuar këtë vakancë, por njëkohësisht edhe çështje të tjera...

**Fatmir Xhafaj** – Zonja Bernhard, urdhëroni!

**Agnes Bernhard** - *(flet përkthyesi)* Në nenin 52 dua të theksoj diçka. Është një ndryshim që e pranuan edhe në nenin 33, në lidhje me paraqitjen e këtyre kandidaturave te

sekretari i Përgjithshëm. Duhet të kemi parasysh afatet. Përpara se t'i dorëzojnë duhet të ezaurojnë afatet, pastaj t'i dorëzojnë këto kandidatura te sekretari i Përgjithshëm.

**Fatmir Xhafaj** – Procedura e sekretarit të përgjithshëm nuk mund të fillojë pa përfunduar afatet përfshirë edhe mbylljen e afatit të ankimit në shqyrtimin e Gjykatës së Apelit dhe Administrativ.

Dakord. Jemi të qartë për këtë.

Për nenin 53 kemi ndonjë gjë?

**Gent Ibrahimi** – Ka një propozim për riformulim të neneve 33, 53 dhe të një neni më poshtë, por meqenëse janë identikë të tria nenet, sepse tregojnë mënyrën e veprimit të Kuvendit për zgjedhjen e kandidatëve që vijnë nga avokatia, nga pedagogët dhe nga shoqëria civile, ka një riformulim i cili do t'ju shpërndahe tani për pak minuta. Unë mendoj që t'i shikojmë në fund.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 54.

**Vasilika Hysi** – Neni 54 bën fjalë për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor që përfaqëson shoqërinë civile. Në fakt në këtë nen, zoti kryetar, sugjeroj që të shihen kriteret lidhur me kriteret që duhet të plotësojë ky anëtar, pasi ky është sikurse të gjithë anëtarët e tjerë në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Një nga shqetësimet e mia është që numri i shoqatave është i lartë, i konsiderueshëm. Janë rreth 2 mijë të regjistruar në tatime. Ky proces kërkon që kandidatët duhet të plotësojnë disa kushte ose kriteret, që janë të përcaktuara në Kushtetutë. Në bazë të Kushtetutës ne mund të plotësojmë ose mund të shtojmë kriteret të tjera në ligj për të qenë më specifik.

Sugjeroj të reflektohet kriteri që personi duhet të ketë të paktën 15 vjet përvojë pune si jurist, sepse është kriter kushtetues. E para.

E dyta, në ligj është thënë që koha e kandidimit është që të ketë qenë i punësuar ose i angazhuar në një organizatë të shoqërisë civile për të paktën 7 vjet. Mua më duket një kohë relativisht shumë e gjatë. Në qoftë se do të kemi parasysh edhe 15 vjetët e përvojës si jurist, sugjeroj të shtohet si kriter, në radhë të parë, të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga shërbimet e inteligjencës përpara viteve '90, të mos jetë bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimit të inteligjencës, të mos ketë asnjë anëtar të familjes që është në detyrë në Këshillin e Lartë Gjyqësor ose kandidat. Pra, të shmangim konfliktin e interesit. Kriteret që tashmë i kemi vendosur ose i kemi sugjeruar edhe për kandidatët e tjerë.



Nga ana tjetër, është mirë dhe do të desha edhe një mendim të ekspertëve, sepse në pjesën e parë të këtij neni flitet për kritere që duhet të plotësojë kandidati. Në pjesën e dytë flitet për kriteret se nga duhet të vijë kandidati. Pra, organizata ku është i angazhuar dhe thuhet që duhet të jetë punonjës, që punon në fushën lidhur me ligjin ose me të drejtat e njeriut. Termi “i lidhur me ligjin” është shumë i gjerë. Të gjitha organizatat punojnë me ligjin.

Nga ana tjetër, në ligj nuk ka një proces paraselektiv, domethënë përzgjedhës, siç thotë neni 147, paragrafi i tretë i Kushtetutës “i është lënë sekretarit të përgjithshëm ta bëjë këtë vlerësim”. Këto janë dy-tri çështje që duhen saktësuar.

**Fatmir Xhafaj** - Faleminderit!

Keni ndonjë koment për këtë gjë, sepse ju la një detyrë ta reflektonit.

**Gent Ibrahimi** – Një koment mund të bëhet aty për aty. Jam dakord që ta zbusim pak atë kriterin e eksperiencës si i punësuar ose i angazhuar me një organizatë të shoqërisë civile. Nga 7 mund të bëhet 3.

Ne sot folëm me Vasilikën dhe me Agnesin. Një ide mund të ishte që të përfshihej edhe Avokati i Popullit si një lloj filtri, por, megjithatë duhet pak kohë që kjo të artikulohet. Kështu që ne do të kërkonim që këtë çështje ta rimarrim ose në fund të ditës së sotme, ose nesër.

**Fatmir Xhafaj** – E para, këto duhen saktësuar dhe forcuar, sepse ka të drejtë... Organizatat e shoqërisë civile punojnë të gjitha me ligjin dhe në 5 vjetët e fundit kanë pasur projekte të këtë fushë.

**Gent Ibrahimi** – Për ta ngushtuar pak fushën në vend që të themi “ligji”, themi “projekte në fushën e sistemit të drejtësisë”. Kjo e kufizon mjaft.

**Fatmir Xhafaj** – Edhe kjo që sapo thatë, që gjithë këtë proces paraparak ta organizojë Avokati i Popullit, nuk do të ishte keq. Mund të jetë një ide. Bisedojeni! Këto kritere duhen forcuar.

Unë madje jam kundër zonjës Hysi që nga 7 vjet të bëjnë 3 vjet. Nëse një njeri nuk është i spikatur... Shoqëria civile ka qenë më e fortë në vitet '90 –'95 se sa tani. Ka 25 vjet e ngritur shoqëria civile.

E dyta, duhet ndalesa. Nuk e di se kush e tha dje, këta që janë shoqëri civile nuk duhet të jenë pedagogë dhe nuk duhet të jenë avokatë, sepse ai mund të jetë avokat dhe hyn edhe të shoqëria civile, është pedagog hyn edhe te shoqëria civile. Jo, nëse është pedagog i brendshëm,

nuk përfshihet te kjo. Nëse ushtron detyrën e avokatit nuk përfshihet te kjo. Pra, janë disa ndalesa... Nuk e mbaj mend se kush e ngriti si problem...

**Biem dakord** që duhet riparë i gjithë ky. Mbetet e hapur. Duhet parë që të jenë kritere shumë më të forta.

Gjithsesi, ne e votojmë në parim me idenë për ta lënë të hapur për t'i riparë ato reflektime që do të bëhen.

**Vasilika Hysi** – Zoti kryetar, meqenëse do të shihet neni 54 të shikojmë edhe kriterin që të mos ketë detyrime në tatime. Pra, organizata duhet të jetë me integritet, të mos ketë pagesa të papaguara dhe në informalitet.

**Fatmir Xhafaj** – Dhe nuk duhet të jenë si individë. Duhet të jenë si organizata.

Neni 55.

**Vasilika Hysi** – Është saktësim në përputhje me ndryshimet kushtetuese.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 56.

**Vasilika Hysi** – Sugjeroj të shtohet, e kemi shtuar edhe tek të tjerat, formulari i vetëdeklarimit të pastërtisë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 57.

**Vasilika Hysi** – Lidhur me nenin 57, ka ndryshime. Është rishikuar në bazë të konsensusit...

**Fatmir Xhafaj** – E kemi atë.

**Vasilika Hysi** – Duhet bërë një ndryshim, zoti kryetar, në paragrafin 3 aty ku thuhet “afati jo më vonë se dy ditë”, duhet “jo më vonë se 3 ditë”.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord. Duhet shtuar edhe paragrafi “në rast se krijohet një vakancë, jep dorëheqjen, ose zëvendësohet nga Kuvendi, sekretari i përgjithshëm të ndjekë të njëjtën procedurë”.

Dakord me shtesën e pikës 6 dhe redaktimet që janë bërë në nen.

Neni 58. Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Vasilika Hysi** – Neni 58 ka qenë neni 92 në variantin e parë. Këtu nuk ka ndryshime, është po i njëjti tekst.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Miratohet neni 58.

Neni 59: “Zëvendëskryetari”.

**Vasilika Hysi** – Nuk kam sugjerime.

**Fatmir Xhafaj** – Kam një pyetje unë.

Thuhet: “Zëvendëskryetari, anëtari më i vjetër në moshë nga radhët e anëtarëve hogjyqtarë”, mos do të ishte më mirë të thuhet: “nga radhët e anëtarëve gjyqtarë”?

**Gent Ibrahim** – Edhe ajo është një logjikë, por ne këtë nuk e kemi parë si një post honorifik. Përderisa ka arsye që roli i kryetarit t’i besohet një jo gjyqtari, ai që do ta zëvendësojë kur të jetë e nevojshme, duhet të ketë po ato karakteristika, pra nuk është një lloj ndarjeje ..

**Fatmir Xhafaj** – Po edhe kjo “anëtari më i vjetër në moshë”, nuk më duket mirë. Le ta zgjedhin vetë ata. Tani, pse i kam thinjat e bardha unë, nuk jam më i mençur se ai tjetri. Pra, si ta dojë vetë trupa.

**Gent Ibrahim** – Natyrisht, kjo është edhe një zgjidhje e shkurtër. Kemi pasur edhe merakun të mos bëhen shumë procese zgjedhore atje brenda se mund të vështirësohen, megjithatë në rast se...

**Fatmir Xhafaj** – Të paktën mund të thuhet: “anëtari më i vjetër...”, ku di unë

**Gent Ibrahim** – Mund të vendosim edhe shortin.

**Fatmir Xhafaj** – Jo, shorti, se na ka kapur alergjia nga shorti. Ne nuk jemi ambasadorë, që të bëjmë short.

**Gent Ibrahim** – Që bashkë me zgjedhjen e kryetarit të zgjidhet edhe zëvendëskryetari, kështu kursejmë një proces zgjedhor. Pra, me po atë proces që zgjidhet kryetari, zgjidhet edhe zëvendëskryetari.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord. Shikojeni!

Neni 60: “Mbledhja plenare e Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

**Vasilika Hysi** – EURALIUS ka një sugjerim. Është shtuar një paragraf i parë lidhur me organizimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, “i cili organizon dhe ushtron veprimtarinë e tij në komisione ose në mbledhje plenare. Kompetencat e këshillit që nuk përmenden në pikën 2 të këtij neni, ushtrohen nga komisionet. Kompetencat që përmenden në pikën 2 të këtij neni ushtrohen nga mbledhja plenare e bazuar në propozimet e komisioneve përkatëse”.

Gjithashtu, në këtë nen sugjerohet qartësimi, dhe ka qenë një kërkesë jona nga diskutimet në komision, shqyrtimi i ankimeve kundër vendimeve të komisionit ku bëhen dhe si

bëhen, pra saktësinë në germën “d”. Njëkohësisht, është bërë një riformulim i pikës 3, por mënyra se si është formular, për mua nuk është e qartë dhe do të kërkoja të kishim një riformulim më të mirë nga ekspertët.

**Agnes Bernhard** – *(flet përkthyesi)* Ne, në fakt, kemi parashikuar edhe diçka tjetër në lidhje me përbërjen e mbledhjes plenare, por, gjithashtu, kemi shtuar edhe diçka se kush do të marrë pjesë në diskutimin në lidhje me marrjen e vendimeve.

Në qoftë se një anëtar ka shprehur një ankesë tek inspektori i lartë, atëherë ky anëtar nuk duhet të marrë pjesë në diskutime dhe në vendimmarrje.

Gjithashtu, edhe në qoftë se kjo ankesë është dërguar në komision dhe komisioni ka marrë një vendim, ky anëtar, që ka bërë kërkesën nuk duhet të marrë pjesë në vendimmarrje.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Faleminderit!

Ne nuk jemi kundër kësaj, por mënyra si është shkruar ky paragraf nuk është e qartë. Këtë e kam për stafin, nuk e kam për zonjën Bernhard. E kam për pjesën shqiptare, ata që e shqipërojnë, sepse praktikisht ky është konflikti i interesit dhe duhet shprehur më qartë, pra shqipërimi është i pasaktë.

Gjithashtu, tjetra që kam te germa “ç”, ku thuhet: “vendos masën disiplinore të shkarkimit mbi gjyqtarin e Gjykatës së Posaçme kundër korrupsionit me 2/3 e votave, me propozimin e Komisionit Disiplinor”. Pse bëhet përjashtim nga gjyqtarët e tjerë? Pse këtë e keni theksuar me 2/3?

**Gent Ibrahimi** – Më duket se është kushtetuese.

**Fatmir Xhafaj** – Është detyrim kushtetues?

**Agnes Bernhard** – *(flet përkthyesi)* Po.

**Fatmir Xhafaj** – Nëse është detyrim kushtetues, dakord, megjithëse nuk jam shumë i qartë për këtë gjë. Gjithsesi, qartësojeni!

Po, zoti Manja.

**Ulsi Manja** – Te pika 3 e nenit 60 përmenden vetëm 2 kompetenca kushtetuese të këshillit: emërimi dhe ngritja në detyrë. A duhet të pasqyrohet ekzaktësisht germa “a” e nenit 147 të Kushtetutës, ku thuhet: “emëron, vlerëson, ngreh në detyrë dhe transferon gjyqtarët e të gjitha niveleve”? Sepse këtu është thënë vetëm “emëron dhe ngreh në detyrë gjyqtarët”, pra të

pasqyrohet saktësisht përcaktimi kushtetues. Në Kushtetutë thuhet: “emëron, vlerëson, ngreh në detyrë dhe transferon gjyqtarët e të gjitha niveleve”.

**Gent Ibrahimi** – Arsyeja kohë. Në pamje të parë kjo është pak konfonduese, sepse duket sikur ky nen i jep më pak kompetenca këshillit nga ç’i jep Kushtetuta, por, në fakt, nuk është kështu, sepse këtu një pjesë e kompetencave mund të ushtrohen nga komisionet dhe një pjesë mund të ushtrohen drejtpërdrejtë nga mbledhja plenare. Në këtë nen janë vetëm ato kompetenca që ushtrohen drejtpërdrejtë nga mbledhja plenare. Pastaj, mbledhja plenare shqyrton edhe ankimet kundër vendimeve të komisionit në fushat e tjera, pra gjithçka që përmendet në Kushtetutë si kompetencë e këshillit dhe që nuk e gjeni në këtë nen, do ta gjeni më poshtë te “Kompetencat e komisioneve”, ka një shpërndarje të...

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, po në qoftë se i shqyrton ankimet ...

*(Diskutime pa mikrofon)*

A është e qartë, zoti Manja?

**Ulsi Manja** – Nuk e di, ndoshta më poshtë janë kompetencat e komisioneve, por përderisa flitet për mbledhjen, pra thuhet: “Këshilli i Lartë Gjyqësor i merr vendimet në mbledhjen plenare”, kështu që për sa kohë ky është lënë si organi më i lartë vendimmarrës i këshillit, atëherë nuk duhet ta ketë, dhe në këtë pikë mund të shtohet edhe transferimi. Gjithsesi, ...

**Fatmir Xhafaj** – E kanë komisionet transferimin.

**Gent Ibrahimi** – Po, faktikisht, i është lënë komisionit. Domethënë një pjesë e atyre kompetencave që parashikohen në Kushtetutë ushtrohen nga komisioni; vetëm ankimet kundër tyre dëgjojnë në mbledhjen plenare, pra ideja ka qenë që në këshill quajmë edhe komisionin. Këshilli vepron në dy formate të ndryshme; ose në mbledhje plenare ose përmes komisioneve. Kjo është një ide e mirë që, në fakt, u sugjerua edhe nga Komisioni i Venecias, që një trupë me këtë përbërje dhe me këtë gjerësi kompetencash duhet patjetër të ndahet në komisione. Ne e kemi interpretuar këtë ndarje jo thjesht si formale, por si një ndarje edhe e kompetencave dhe e përgjegjësisë. Kështu që në këtë logjikë është ecur në këtë kapitull, që disa kompetenca ushtrohen nga fillimi deri në fund nga komisionet, si transferimi, për shembull, dhe vetëm ankimet kundër tyre shqyrtohen nga mbledhja plenare.

**Vasilika Hysi** – Zoti, Ibrahimi, për të qenë korrekt: Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka në dorë caktimin në pozicion, transferimin, komandimin dhe riemërimin, pra pasi personat

kanë hyrë në sistem, komisioni i karrierës, në qoftë se ju kam kuptuar drejt, bën këto lëvizje, ndërsa emërimin dhe ngritjen në detyrë ia keni lënë mbledhje së përgjithshme. Ndërkohë, te germa “d”, thuhet: “Mbledhja e përgjithshme shqyrton edhe ankimimet kundër vendimeve të komisionit, me përjashtim të atyre vendimeve që rrëzojnë vendimin e inspektorit të lartë të drejtësisë për arkivimin e ankimimit dhe pushimin e hetimeve”. Kurse pika 3, sikurse e thashë duhet qartësuar.

**Fatmir Xhafaj** - Dakord me nenin 60

Neni 61: “Komisionet e përhershme të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

**Vasilika Hysi** – Në paragrafin e parë ka një saktësim të terminologjisë, pra për cilat komisione të përhershme flitet, duke shtuar të “Këshillit të lartë gjyqësor që ushtrojnë veprimtarinë”.

Gjithashtu, unë kam një pyetje në lidhje me pikën 6, ku thuhet: “komisionet zgjedhin kryetar të tyre në bazë të propozimit të kryetarit të këshillit”. Pse i lihet kryetarit të këshillit që të bëjë edhe propozimet për kryetarët e komisioneve?

**Gent Ibrahimi** – Ka dy arsye.

E para, është një përpjekje për të forcuar rolin e kryetarit, duke pasur parasysh aktivizimin e përgjegjësive brenda këshillit nëpër komisione. Na është dukur si një mënyrë për të forcuar disi rolin e kryetarit, të cilin në fund të fundit, e kemi drejtues administrativ të institucionit, si dhe për të bërë pak ekonomi, për t’i kursyer këshillit debate në komisione. Pra, kur ka një propozim, gjithçka zgjidhet më shpejtë dhe më mirë. Pra, këto të dyja janë arsyet. Nuk e di nëse ju do t’i quani të mjaftueshme, por, pa dyshim, që ka edhe një zgjidhje alternative, ajo e zgjedhjes nga vetë anëtarët e komisionit, por arsyet tona kanë qenë këto: forcimi i rolit të kryetarit dhe pak ekonomi brenda punës së këshillit.

**Agnes Bernhard** – *(flet përkthyesi)* Zgjedhja e kryetarit nuk duhet të lihet në dorën e kryetarit dhe, gjithashtu, mund të kemi edhe një risk tjetër, që kryetari nuk do të veprojë në qoftë se nuk do të kishte një propozim që të vinte nga vetë kryetari.

Pra, duhet të marrim në konsideratë që vetë kryetari duhet të drejtojë këtë propozim.

**Petrit Vasili** – Me sa di unë, ne nuk kemi ndonjë detyrim, duke u konsultuar edhe me kolegët, lidhur me komisionet që kemi për mënyrën se si janë të përbërë këto 5 komisione. Ne konstatojmë këtu që anëtarët e komisionit mund të jenë anëtarë në jo më pak se 2 komisione, pra

mund të jenë në dy komisione, pra një anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor mund të jetë anëtar në dy komisione.

Unë mendoj se gjëja më normale që duhet të bënim ishte të ndërtonim komisionin në raport me numrin e anëtarëve që kemi, pra të jetë një strukturë, e cila të jetë edhe funksionale. Ne i kemi vënë një detyrim edhe në parlament, që në komisionet tona përkatëse një anëtar duhet të jetë anëtar në një komision. Në vend që të ndërtonim 5 komisione, të cilat krijojnë atë përputhje, mund të shikonim edhe një rindërtim tjetër, kur themi për shembull Komisioni i Planifikimit Strategjik dhe Administrimi i Buxhetit mund të ishte një komision, Komisioni Disiplinor i Zhvillimit të Karrierës mund të ishte një e të tjera dhe të mund të rindërtonim edhe tre komisionet dhe do të kishim në çdo komision numrin e anëtarëve që veprojnë brenda komisionit. Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor është jashtë komisioneve bashkë me zëvendëskryetarin dhe kemi një strukturë të ekuilibruar; anëtarët merren dhe fokusohen në çështjet e tyre, kurse për zgjedhjet e tyre ka rezultuar dhe rezulton edhe në praktikën, parlamenti e ka një praktikë të gabuar të cilën e ka ndrequr, këta ta reflektonim edhe këtu. Ne nuk i shtojmë asnjë vlerë kësaj pune. Është më racionale dhe më funksionale në të gjithë kuptimin e fjalës; japim mundësi që edhe më tej, edhe në marrëdhëniet me ndërkombëtarët, për t'u thelluar më shumë në çështje të caktuara. Di që ky komision është më i specifikuar në një çështje dhe thellohet në punët e ti dhe merren vendime gjithmonë e më të ekuilibruara, edhe për një arsye tjetër, sepse komisioneve këtu u japim kompetenca të rëndësishme. Nuk mund t'i çojmë anëtarët nga njëri te tjetri kështu. Kjo gjë duhet parë në mënyrë më racionale.

**Gent Ibrahimi** – Ne jemi të bindur që kjo ndarja e punës në komisione është një zgjidhje e mirë për hir të efektivitetit dhe të përgjegjshmërisë.

Së dyti, do të thosha se këto 5 komisione korrespondojnë me 5 grupe kompetencash natyrore të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Natyrisht, mund të bëheshin edhe tre, mund të grupohen disa kompetenca, por disa prej tyre është vështirë t'i gruposh, sepse krijojnë konflikte midis tyre. Për shembull, kompetencat e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës nuk mund t'i përzihesh me kompetencat e Komisionit për Vlerësimin e Performancës, sepse vlerësimi i performancës është ai që çon te zhvillimi i karrierës. Kështu që ka hapësirë për reduktimin e numrit të komisioneve, por ne na duket se numri 5 i korrespondon grup kompetencave natyrore të këshillit. Për sa i takon llogarisë së numrave, ne e kemi bërë disa herë aritmetikën, sepse mund të ndodhin edhe ngatërresa, është e vërtetë, dhe na rezulton që ky numër anëtarësh për komision dhe me këtë

rregull, që një anëtar nuk mund të shërbejë në më shumë se dy komisione dhe që nuk mund të jetë kryetar në më shumë se i komision, funksionon. Pra, kjo përbërje me 11 anëtarë, me këtë ndarje nëpër komisione dhe me këto rregulla shtesë nga ana aritmetike, funksionon.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në këtë fazë, ne mund të themi që në qoftë se ka 5 anëtarë gjyqtarë, dhe këtu ka një rregull, që në dy nga pesë komisionet duhet të ketë të paktën 2 anëtarë gjyqtarë, sigurinë që kjo funksionon, e kemi, pra ka aq anëtarë gjyqtarë këshilli që të plotësojë komisionet sipas këtyre raporteve dhe sipas këtyre kërkesave që kemi vendosur ne. Kjo vlen edhe për anëtarët jogjyqtarë.

**Petrit Vasili** – Kam një koment tjetër që ka lidhje po me këtë gjë. Praktikisht, ka diçka, pra është një kalkulim që bëhet ftohtë-ftohtë që në fillim të kësaj gjëje.

Këto komisione janë të dizbalanuara për sa i takon ngarkesës që kanë. Nuk mund të ketë Komisioni i Planifikimit Strategjik të tjera të njëjtën punë që ka Komisioni Disiplinor apo i Zhvillimit të Karrierës. Pikërisht, kjo dizbalancë kërkon anëtarë, të cilët duke qenë pjesë e një trupe fikse, pra të zgjedhur përfundimisht që të bëjnë atë detyrë, edhe është zhdërvjelltësohen shumë më tepër dhe kanë mundësi të ecin më shumë në çështje, çështje zëvendësimi, sepse rrethanat e caktuara apo dublimi do të bëjnë shpeshherë, në mënyrë të paevitueshme, sado koordinime perfekte të ketë, do të bëjë gjithmonë që të mbivendosen mbi njëri-tjetrin. Kjo zgjidhje që ne u ofrojmë, është që edhe fushat t'i zhvillojmë, por, njëkohësisht, ka edhe diçka tjetër, janë të qartë të gjithë se çfarë bëjnë dhe ka një grup detyrash, të cilat na interesojnë në këtë fazë, në mënyrë të veçantë, që është reforma, që ata të jenë të fokusuar në këtë gjë. Nuk është çështje thjesht matematike. Matematika shkonte në funksion edhe të, sepse e sollën që propozimi alternativ kënaqte edhe numrat, por nuk ishin numrat qëllimi i vetëm.

Duke e bërë në këtë mënyrë, sepse unë nuk do të kisha qëndruar në këto komente fare nëse komisionet nuk do të kishin peshën që kanë, pra kanë goxha peshë dhe duke pasur peshë gjëja e parë është që të krijojnë një mikrohabitat të tyre, edhe ata që janë, janë pjesë e një dinamike të caktuar, sipas ngarkesave të cilat mund të jenë nga më të çuditshmet, sepse ju e kuptoni fare mirë që Komisioni i Administrimit të Buxhetit, ju thoni që mund të ketë punë shumë më pak nga të tjerët dhe rigrupimi i tyre na çon në realitetin e punëve dhe nuk është se ne heqim një nga kompetencat apo nuk ia mundësojmë ta zhvillojë, por rigrupimi i tyre është një praktikë normale që ndodh kudo; edhe në parlament kemi rigrupuar komisione. Kemi pasur komisione që kanë pasur një problematikë, pastaj janë rindërtuar, duke pasur edhe peshën në njërin, me



përrjashtim të komisioneve, që janë tipike dhe nuk lëvizin, që kanë një emërtim të caktuar, te të tjerat mund të luhet. E them këtë gjë, sepse e kemi shumë më të lehtë për t'ua shpjeguar të gjithëve. Të themi: “po, kemi këto problematika të mëdha administrative, zhvillimore e të tjera qëndrojnë këtu. Këto që kanë të bëjnë me vlerësime të praktikës së përditshme dhe kjo gjëja tjetër dhe kemi tre çështje të mëdha”, dhe orientohen më kollaj. Nuk do të jetë fundi i botës sikur asgjë nga këto që them unë të mos pranoni, por mendoj se ka diçka që mund të rishikohet në mënyrë më racionale.

**Fatmir Xhafaj** – Unë e kuptoj që Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale nuk mund të bashkohet me Zhvillimin e Karrierës apo me atë Disiplinor, por Komisioni për Planifikimin Strategjik dhe Administrimi i Buxhetit, i bie të mblidhet një herë, 2 herë në një vit, pra këto mund të bashkohen, për shembull, sepse nuk kanë as konflikte interesi dhe janë komisione, ku njëri nga këta për shembull, nuk ka punë fare, ngelet pa punë fare, në kuptimin që ka ngarkesë minimale dhe nuk ka probleme me atë të buxhetit, kështu që shikoheni se çfarë mund të rregulloni te kjo.

Dakord, me vërejtjet që u bënë dhe me ndryshimet që janë pasuruar këtu.

**Vasilika Hysi** – Lidhur me “anëtarët zëvendësues”, te paragrafi 5, sepse në këshill mund të ketë anëtarë dhe anëtarë zëvendësues. Këto rregulla do të zbatohen edhe për anëtarët zëvendësues?

**Gent Ibrahimi** – Rregulli që një anëtar i këshillit nuk mund të jetë anëtar në më shumë se 1 komision,...

**Fatmir Xhafaj** – Duke u reduktuar komisionet, kjo do të jetë më elastike.

**Gent Ibrahimi** – Duhet të bëjmë llogari matematikore. Tani që është me një komision duhet bërë matematika dhe pastaj mund të kthejmë përgjigje.

**Fatmir Xhafaj** – Keni shumë të drejtë, sepse janë kompetenca që nuk mund të mbivendosen, sepse krijojnë konflikt.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pra, te neni 62 ka një ndryshim, ku të futet fjala “plenare”. Dakord.

Neni 63: “Ekspertët”

**Vasilika Hysi** – Po, ka diçka zoti kryetar që ekspertët që mund të vijnë nga fusha e gjyqësorit mund të angazhohen gjyqtarë në detyrë, por gjyqtari në detyrë e ofrojnë shërbimin e tyre pa pagesë, meqenëse në Kushtetutë nuk lejohet që gjyqtarët të marrin pagesa, pra është

reflektuar shmangia e konfliktit të interesit dhe ndalesat që kanë për të ushtruar funksione të tjera.

**Fatmir Xhafaj** – A mund të ma shpjegoni se çfarë do të thotë “të ketë ekspertë të këshillit të jashtëm”. Për çfarë është fjala, çfarë do të bëjë Këshilli për ekspertë të jashtëm. Kësaj i thonë: shto ujë e shto miell.

**Gent Ibrahimi** – Në fakt, kjo është një dispozitë që hap rrugën për një diçka se sa një dispozitë që do të zbatohet në punën e përditshme të Këshillit. Ata mund të kenë nevoja për shërbime statistikore, përtej atyre që ofron administrata, mund të kenë nevoja për një vlerësim të performancës të aspekteve të veçanta të punës së vetë këshillit. Në përgjithësi,...

**Fatmir Xhafaj** – Mos e zgjero, sepse do të shkojmë pastaj kundrejt shpërblimit e të gjitha me radhë, të kemi të drejtë të marrim ekspertë. Ju lutem, shikojeni këtë! Ne nuk jemi dakord. Kanë staf, kanë gjyqtarë, le t’i marrin. Dakord jam unë, gjyqtarët mund të thërriten për ligjet që mund të bëhen, për propozime ligjesh e ku di unë, të bëjnë analiza, të bëjnë strategji, të ngrenë grupe pune praktikisht me gjyqtarë, pra mund të angazhohen. E vendos këshilli dhe mund ta vendosni, nuk ka nevojë as me pagesë të gjësë, sepse kuptohet.

**Gent Ibrahimi** – Janë këto problemet: kohëzgjatja optimale e kategorive të ndryshme të çështjeve, ngarkesa optimale e punës së gjyqtarëve, domethënë janë disa çështje që mund të kërkojnë ekspertizë nga njerëzit që janë në terren.

**Fatmir Xhafaj** - Ne jemi duke bërë një eksperiment të madh me faktin që e kemi vënë Këshillin me kohë të plotë. Tani, t’u japim edhe ekspertë. Ne nuk dimë sa ngarkesë do të kenë ata, t’u themi: jeni edhe ekspertë dhe ata pastaj do të menaxhojnë 400 veta. Nuk jemi dakord për këtë gjë, kështu që...

**Agnes Bernhard** – (*flet përkthyesi*) Mund të kemi një rast të tillë që një gjyqtar mund të mos jetë në gjendje të mirë shëndetësore ose mund të mos jetë i aftë për të kryer detyrën dhe në këtë rast ne marrim mendimin e një eksperti të një doktori të na thotë se deri në çfarë mase ky gjyqtar nuk është në gjendje të...

**Fatmir Xhafaj** – u drejtoheni ekspertëve të jashtëm, të kualifikuar, por nuk merren ekspertë nga komisioni për të bërë një nen, domethënë: ai nuk merr pjesë në mbledhje plenare, pastaj fusni këtu: “eksperti nuk mund të marrë pjesë në vendimmarrje ose votim”. Po kjo nuk ka kuptim fare. Hiqeni këtë ose ky nen duhet reduktuar i gjithi. Mund të bëni një nen të

përgjithshëm, që mund të angazhohen gjyqtarët e të tjera dhe kur ka nevojë për ekspertiza atje, veprohet sipas ligjit.

Dakord me nenin 63, me ndryshimet.

Neni 64: “E drejta për të kërkuar informacion”.

Ka disa redaktime te pika 2, ku thuhet: “...në mbledhjet plenare për të paraqitur provat dhe për të dëshmuar në lidhje me çdo çështje”.

Unë kam diçka për pikën 3, ku thuhet: “Përfaqësuesit e këshillit kanë të drejtë të hyjnë në ambientet zyrtare të çdo organi të sistemit gjyqësor, të kopjojnë ose të marrin informacione apo dokumente që nevojiten për ushtrimin e funksionit të këshillit”. Këtë unë nuk e kuptoj dot. Pra, thuhet: “përfaqësuesit e këshillit kanë të drejtë”, kush janë përfaqësuesit e këshillit. Çfarë kuptoni me këtë gjë?

**Gent Ibrahimi** – Kjo mund të jetë edhe një mbetje nga koha kur këshilli ishte i pajisur me funksionin e inspektimit. Një gjuhë e tillë, natyrisht më e fortë, gjendet më poshtë te kreu për inspektorin e lartë, megjithatë ne mendojmë që ka hapësirë për një rregull të tillë për të parandaluar çdo problem në praktikë, ku një kryetar gjykate bëhet pengesë për përfaqësuesit e këshillit ..

**Fatmir Xhafaj** - Por ai shkarkon kryetarin e gjykatës. Kush e emëron kryetarin e gjykatës?

**Gent Ibrahimi** – Pa dyshim që ka autoritet mbi ta, por...

**Fatmir Xhafaj** – Këshilli i lartë gjyqësor është organ ekzekutiv, apo jo ?

**Gent Ibrahimi** – Kjo, në fakt, është një reminishencë nga koha kur këshilli kishte inspektim, tani që nuk ka më kjo edhe mund të hiqet. Ne e lamë thjesht për të qenë brenda.

**Fatmir Xhafaj** – Të paktën të jetë e zbutur, jo kështu siç është, sepse këtu duket si një trupë e fortë, do të hyjë atje do të marrë materialet, pra nuk ka kuptim. Gjuha e përdorur është pak e ashpër, pra thuhet: “çdo organ publik, person fizik apo juridik është i detyruar të vërë në dispozicion këshillin, si dhe nevojitet ...”, e gjitha kjo: “E drejta për të kërkuar informacion” është një dispozitë që duhet zbutur.

Atëherë, dakord me ndryshimet dhe me sugjerimet që u bënë. Mbledhja e Këshillit të Lartë Gjyqësor neni 65, thirrja e mbledhjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor ka dy ose tre redaktime te pika 4 dhe te pika 6 për saktësime.

Dakord?

8 dhe 9 janë...

**Vasilika Hysi** – Kryetar, nuk ka gjë pika 6, është korrekte, është rendi i ditës.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord me redaktimet e bëra te neni 65.

Nenin 66 e bëra dakord.

Neni 67, kuorumi dhe vendimmarrja në Këshillin e Lartë Gjyqësor, duhet saktësuar. Ka vetëm një ndryshim në paragrafin e parë, kuorumi i nevojshëm për zhvillimin e mbledhjeve plenare. Këshilli i Lartë Gjyqësor është kur në të marrin pjesë jo më pak se 7 anëtarë.

**Vasilika Hysi** – Minimumi 7 anëtarë.

**Fatmir Xhafaj** – Pse 7 anëtarë? Ata janë me kohë të plotë.

**Ulsi Manja** – Ndoshta është e nevojshme ta shohim kuorumin dhe vendimmarrjen, sepse kur mbledhjet janë të vlefshme, jo më pak se shtatë anëtarë dhe në paragrafin e dytë thotë që vendos me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, i bie që, nëse në mbledhje do të marrin pjesë 7 anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, me 4 vota emërohesh gjyqtarë në Shqipëri.

Gjithsesi unë nuk e di si është praktika, por numri i nevojshëm i votave për vendimmarrje, numri 4, më duket shumë i ulët nga 11 anëtarë që ka këshilli.

**Vexhi Muçmataj** – Mundem kryetar?

**Fatmir Xhafaj** – Po!

**Vexhi Muçmataj** - Unë mendoj që duhet vënë një pikë këtu, që pjesëmarrja e anëtarëve të këshillit duhet të jetë e detyrueshme.

**Fatmir Xhafaj** – Si rregull është e detyrueshme.

**Vexhi Muçmataj** – Jo si rregull, por duhet të jetë.

**Fatmir Xhafaj** – Për arsye objektive dhe shëndetësore mund të mos jetë.

**Vexhi Muçmataj** – Kur ka shkaqe të natyrshme, natyrisht, por jo me 7 anëtarë.

**Agnes Bernhard** – *(flet përkthyesi)* Mund të kemi edhe situata të tilla, kur njëri nga anëtarët e këshillit mund të ketë konflikt interesi.

**Fatmir Xhafaj** – Është sqaruar ajo.

**Agnes Bernhard** – *(flet përkthyesi)* Mund të jetë edhe një situatë tjetër, kur një komision është duke marrë ndonjë vendim për shkelje disiplinore, atëherë duhet që këshilli të jetë në gjendje që të marrë një vendim.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord. Në vëmë rregullin e përgjithshëm që të jetë detyrues dhe pastaj... pikë dhe më poshtë janë rastet pwrjashtimore kur ai mund të mungojë në raste të arsyeshme, por jo gjithmonë jo më pak se kaq.

Dakord me ndryshimet?

Neni 68, dokumentimi i mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Vasilika Hysi** – Kur thuhet përpara publikimit, në paragrafin e dytë ka vetëm dy saktësime. Njëkohësisht kemi pasur një diskutim se çfarë do të bëhet pas një mbledhje? Dhe siç diskutuam edhe në fillim, kur kemi diskutuar këtë nen, botohet një përmbledhje e diskutimeve. Gjithashtu, në paragrafin e katërt, aty ku thuhet se çfarë janë shënimet që duhet të përmbahen për mbledhjen e diskutimeve, aspektet kryesore të çështjeve të diskutuara dhe propozimet për vendimet duhet të jenë pjesë e përmbledhjes së diskutimeve.

**Fatmir Xhafaj** – Unë jam dakord, por ju thoni që regjistrimi audio e mbledhjes plenare bëhet publike brenda 24 orëve nga dita e mbledhjes. Pra, çfarë procesverbali do të votoni, kur ju e keni dhënë audio?

**Vasilika Hysi** – Në rast se ju kujtohet në diskutim kjo është bërë për ekonomi dhe ekspertët atëherë thanë që kushdo të dëgjojë mund të shkojë të dëgjojë audio, por për të zbardhur në letër të gjitha diskutimet brenda një periudhe kaq të shkurtër kohe, është e pamundur. Megjithatë, në nenin 6 shqetësimi juaj është zgjidhur, sepse sugjerojmë që në qoftë se regjistrimi konfirmon pasaktësi me zbardhjen për mbledhjen e procesverbalit, atëherë ai mund të korrigjohet dhe jepet në vijimësi mënyra së si korrigjohet, ose me urdhër të Kryetarit, ose me vendim të këshillit në mbledhje plenare.

Mbaj mend kur kemi diskutuar këtë, zoti Ibrahim, ka dhënë disa sqarime.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, sepse nuk e kisha të qartë unë.

Neni 69, janë vetëm referencat e ligjeve, mesa shoh këtu ka nevojë.

Dakord!

Neni 70, marrëdhëniet e Këshillit të Lartë Gjyqësor me ministrin e Drejtësisë.

**Vasilika Hysi** – Ky është një nen për të cilin ka pasur komente nga kolegu Vasili, lidhur me marrëdhëniet e Këshillit të Lartë Gjyqësor me ministrin e Drejtësisë.

**Fatmir Xhafaj** – Edhe nga unë ka pasur komente, sepse edhe unë ndaj të njëjtin vlerësim.

**Vasilika Hysi** - Edhe nga ju. Njëkohësisht, në mbledhje ky u la një nen i hapur për t'u riformuar nga ekspertët dhe ekspertët kanë sjellë një reformulim. Zonja Agnes, ka riformulimin.

**Agnes Bernhard** – *(flet përkthyesi)* Ne mund të shtojmë një paragraf te ky nen që lidhet me kompetencat e ministrit të Drejtësisë në lidhje me përgatitjen e akteve nënligjore, duke ndjekur një opinion të dhënë më së pari nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe që të paraqesë ankesat në lidhje me shkeljet disiplinore tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe të kërkojë inspektimin tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Gjithashtu, një ide tjetër që mund të shtojmë, është se ministri i Drejtësisë mund të marrë pjesë në mbledhje të ndryshme të përgjithshme që mund të kryej Këshilli i Lartë Gjyqësor.

**Fatmir Xhafaj** – Në qoftë se mbaroi zonja Agnes, unë kam një sugjerim, që këtu i duhet lënë e drejta ministrit, ose një përfaqësuesit të tij të marrë pjesë rregullisht sa herë që është e nevojshme si vëzhgues, të paktën në mbledhjet e këshillave, ai duhet të jetë i informuar, ta ndjekë. Unë se kuptoj dot që shkon EURALIUS-i në çdo mbledhje të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe nuk shkon ministri i Drejtësisë, apo ndonjë përfaqësues i tij të shohin se çfarë zhvillohet aty, live. Kur e çmon të arsyeshme vetë këshilli, për çështje të caktuara shkon vetë ministri, ashtu siç propozuat ju, por ai ta ketë të drejtën që një përfaqësues i autorizuar i ministrit të marrë pjesë si vëzhgues në mbledhjet e komisioneve, transparencës dhe mbledhjet e këshillit dhe ata i njoftojnë që është mbledhja e këshillit dhe përfaqësuesi i orienton për projektligjet që zhvillon, për strategjitë që ka ministri, për bashkëpunimin. Ky nuk ka kufizim kushtetues, apo jo?

*(Ndërhyrje në anglisht)*

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, por ai nuk ndikon në vendimmarrje dhe, për sa kohë që nuk ndikon dhe nuk përfshihet në vendimmarrje, nuk e cenon këtë princip dhe këtë rekomandim të Komisionit të Venecias.

**Gent Ibrahimi** – Ndoshta si një zgjidhje të mesme mund ta kufizojmë të drejtën e ministrit për pjesëmarrje vetëm në mbledhjet plenare.

**Fatmir Xhafaj** – Po, i pranishëm ministri në mbledhjet plenare, por edhe një vëzhgues në komisione.

Zonja Bernhard është përfaqësuese e EURALIUS-it, sot shkon në çdo mbledhje të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, nesër një përfaqësues tjetër do të shkojë edhe në mbledhjet e

seancës plenare, edhe në komisione. Pse të mos shkojë përfaqësuesi i ministrit të ndjekë zhvillimin e mbledhjes dhe të komisioneve?

**Agnes Bernard** – *(flet përkthyesi)* Edhe unë jam dakord me këtë, që jo vetëm ministri, por çdo qytetar mund të marrë pjesë, sepse mbledhjet quhen të hapura.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, qytetari duhet të bëjë kërkesë e të tjera, por ne duhet ta shprehim në ligj që ai ka të drejtën dhe njoftohet për zhvillimin e mbledhjeve, s’ka asgjë të keqe, ai njoftohet kur ka mbledhje komisionesh dhe ai thotë që po. Zëvendësministri, drejtori i Kodifikimit dhe drejtori i Çështjeve Gjyqësore në Ministrinë e Drejtësisë, të gjithë këta shkojnë, asisitojnë dhe ndjekin mbledhjen e komisionit. Kjo lloj transparence është përgjithësisht për të gjithë komisionin. Nuk kemi cenim kushtetues të kompetencave kushtetuese.

Ju lutem reflektojeni këtë gjë.

Dakord!

**Agnes Bernard** – *(flet përkthyesi)* Kam edhe një shtesë tjetër në paragrafin katër, ku mund të shtojmë të dhënat statistikore.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord me ndryshimet dhe sugjerimet që u bënë, që u pranuan, dakord edhe me ato që parashtrori vetë zonja Bernhard për rishikimin e këtij neni në reflektim të sugjerimeve të paraqitura nga kolegët dhe ato çfarë u thanë sot.

Dakord, faleminderit!

Vazhdojmë me nenin 71, “Marrëdhënia e Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

**Vasilika Hysi** – Për nenin 71 u kemi kërkuar ekspertëve ta riformulojnë për të rregulluar më mirë këto marrëdhënie. Ekspertët kanë një reformulim.

**Agnes Bernhard** – *(flet përkthyesi)* Edhe këtu kam një propozim. Ministri i Drejtësisë, drejtuesi i Gjykatës së Lartë, i Gjykatës Kushtetuese, gjykatës Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, i Prokurorisë së Posaçme dhe Prokurori i Përgjithshëm mund të marrin pjesë në këto mbledhje si vëzhgues, kur diskutohen tema të përgjithshme që lidhen me sistemin e drejtësisë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Meqë jemi këtu te marrëdhëniet, në atë që ne e kemi quajtur bashkëpunim institucional, në kushtet që kemi shumë organe, a mund të kemi një takim, të paktën një herë në vit, ose dy herë në vit, pra një mbledhje të përbashkët të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, kryeinspektorit, prokurorit të Përgjithshëm dhe ministrit të Drejtësisë, ku të diskutojnë çështje të drejtësisë me një tematikë të caktuar se cilat janë problemet që preokupojnë,

konfliktet që mund të kenë lindur ndërmjet institucioneve, nevojën se si mund të bashkëpunohet, shqetësime që ka sistemi dhe në atë tryezë, të paktën dy herë në vit këta të koordinojnë për të trajtuar çështje të mëdha të drejtësisë në vend dhe aty mund të lëmë mundësi që t'i adresohet në emër të Kuvendit, në emër të Presidentit të Republikës që t'i japë pak solemnitet kësaj gjëje. Kjo është një mbledhje pune, ku mund t'i adresohen duke filluar që nga Presidenti i Republikës që ka një sërë kompetencash në fushën e drejtësisë, që gjithashtu i mbeten, Kuvendit, komisionit përkatës, sepse ka një Komision Ligjesh, ku sot jemi ne, nesër do të vijnë disa të tjerë që do t'i adresohen, por nuk ka shumë rëndësi se kush është këtu. Të gjithë janë aktorë të rëndësishëm, pra aktorët që kanë punë me drejtësinë të mblidhen të paktën një herë në vit, duhet të ulen në një tavolinë, sepse ne ulemi vetëm në qoftë se na ulin EURALIUS-i, OPDAT-i, BE-ja apo Ambasada e Shteteve të Bashkuara. Është shumë i mirë roli i tyre, por ne po e ndërtojmë të gjithë këtë sistem që të vetërregullohet dhe këtë reformë po e bëjmë që të kemi mundësi që ky sistem të funksionojë në mënyrë eficiente dhe të jetë i koordinuar dhe i organizuar. Pse të mos e kemi vetë ne një tryezë të tillë? Kush mund ta drejtojë? Nuk e di, formulojeni dhe ta shohim, ndoshta Presidenti i Republikës, kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, kryetari i Gjykatës së Lartë, ose kryetari i Gjykatës Kushtetuese, të cilët janë personalitete në një vend. Ata duhet të jenë pjesë e kësaj tryeze dhe duhet të dinë se cilat janë shqetësimet që vijnë në Gjykatë të Lartë, duhet ta dijë këshilli dhe jo kur ata takohen rastësisht me njëri-tjetrin. Pa dyshim që ata shkëmbejnë me njëri-tjetrin, por le të ketë një mbledhje e kësaj natyre, një gjë e tillë, të paktën një herë në vit dhe sa herë që shihet e arsyeshme. Nuk e di si mendojnë kolegët për këtë gjë?

**Vasilika Hysi** – Zoti Kryetar, te neni 70 ne kemi rregulluar...

**Fatmir Xhafaj** – Jeni dakord që ta institucionalizojmë një tryezë të tillë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk e di si mund të jetë, quajeni Këshilli i Drejtësisë, tryeza e mbledhjes së aktorëve të drejtësisë, pra po e quaj bashkëpunimi ndërinstitucional.

Dakord, faleminderit!

Të jem i sigurtë nuk ishte tërësisht ideja ime, e kam të huazuar gjatë debateve që janë bërë për reformën. Nuk dua t'ia njoh vetes meritën për këtë gjë, sepse ka qenë një çështje e diskutuar, por nuk ishte e reflektuar.

Neni 71, dakord me atë që u parashtrua edhe nga zonja Agnes te paragrafi i parë.



Konflikti i interesave, neni 72, detyrimi për të deklaruar konfliktin e interesit, nuk shoh ndryshim.

Keni ndonjë sugjerim?

Dakord!

Neni 73, “Papajtueshmëria për shkak të pjesëmarrjes në procedim”, ka dy-tre ndërhyrje redaktoriale të teknikës legislative. Si në komisionin disiplinor, ashtu edhe në mbledhjen plenare, ekspert ose në çdo cilësi tjetër, por për ekonomi kohe nuk po i përmend më gjatë.

Dakord me nenin 73?

Neni 74, “Papajtueshmëria për shkak të lidhjes familjare, gjinie, ose krushqie”, ka një riformulim redaktorial të paragrafit të parë, është për paraqitje më të mirë për efekt të teknikës legislative.

Kemi gjë tjetër këtu?

Dakord me ndryshimet e nenit 74, të teknikës legislative.

Neni 75, heqja dorë.

Zonja Hysi keni gjë këtu?

Neni 75, pika 1 është një riformulim për efekt të teknikës legislative, kurse të gjitha pjesët tjera janë për efekt redaktimi dhe për efekt të teknikës legislative.

Dakord me ndryshimet?

Neni 76, përjashtimi i anëtarit. Gjyqtari ose nëpunësi civil mund të kërkojë përjashtimin e anëtarit të këshillit.

Dakord me ndryshimet redaktoriale te neni 76?

Neni 77, administrata e këshillit. Nuk ka ndryshime.

Neni 78, sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ndërhyrje pa mikrofon

Kemi edhe këtë jo agjendat, por agjendat.

Faleminderit!

Dakord me nenin 78 me ndryshimet e propozuara.

Neni 79, organizimi i administratës.

Dakord!

Neni 80, konflikti i interesave.

Dakord!

Vazhdojmë me funksionin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, neni 81, objektivat.

**Vasilika Hysi** – Në fakt, këtu zoti kryetar, kam kërkuar që ekspertët ta rregullojnë terminologjinë. Këtu flitet për parime, nuk flitet për objektiva. Këtu janë parimet e funksionimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord!

Genti, parazitare është e gjithë kjo, nuk thotë ndonjë gjë të veçantë, sepse e kemi thënë që në hyrje të ligjit, ndoshta duhet hequr. Përderisa e keni në hyrje të ligjit këtë gjë, parimet thoni në hyrje të projektligjit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

S'ka rëndësi, sepse të gjitha organet të njëjtat parime kanë, s'kanë parime të ndryshme. Të njëjta i kanë parimet, efencën, parimin e statusit të gjyqtarit, të prokurorit, efencën, llogaridhënien dhe pavarësinë, nuk ka parime të ndryshme.

Neni 81, bie.

Dakord?

Po.

Neni 82, planifikimi strategjik. Këshilli Lartë Gjyqësor është vendosur në bashkëpunim me ministrin e Drejtësisë.

**Vasilika Hysi** – Ekspertët kanë sjellë një riformulim që e rregullon më mirë shqetësimin që është ngritur në mbledhjet e kaluara, se si mund të koordinojë më mirë Këshilli i Lartë Gjyqësor me Ministrinë e Drejtësisë. Ekspertët mund ta lexojnë.

**Fatmir Xhafaj** – Po, zoti Ibrahim!

Zonja Agnes!

**Agnes Bernhard** – *(flet përkthyesi)* Do të doja të shtonim një paragraf tjetër, ku plani strategjik duhet të jetë në të njëjtën kohë dhe në të njëjtën kornizë me planin strategjik të sektorit të Ministrisë së Drejtësisë, i cili do të tregojë përmbajtjen e këtij plani strategjik, duke përcaktuar misionin dhe vlerat e gjyqësorit, të analizojë profilin e gjyqësorit, të përcaktojë çështjet strategjike dhe të përcaktojë prioritetet, të përcaktojë monitorimin, vlerësimin dhe raportimin në lidhje me këtë strategji, e cila duhet të shoqërohet me një plan veprimi, i cili duhet të përfshijë treguesit objektivë, aktivitetet, treguesit financiar, si dhe indikatorët e tjerë plotësues. Ne duhet të përcaktojmë që Këshilli i Lartë i Gjyqësorit duhet të ketë një kuadër pak më të gjerë në lidhje me

strategjinë sesa ai kuadër që ka Ministria e Drejtësisë. Gjithashtu duhet të sigurojë që të ketë një bashkëpunim midis strategjisë së Ministrisë dhe Këshillit.

**Fatmir Xhafaj** – Jemi dakord me arsyetimin dhe me propozimin, por sot silleni të formuluar që të kalojë bashkë me projektin.

Dakord?

Dakord, faleminderit!

Neni 83, raportimi publik dhe para Kuvendit.

**Vasilika Hysi** – Këtu ka thjesht çështje redaktoriale.

**Vexhi Muçmataj** – Kryetar, mundem?

Te pika 4 e nenit 83, rekomandimet e përcjella në rezolutën e miratuar nga Kuvendi, raporti vjetor i Këshillit të Lartë Gjyqësor, nuk duhet të cenohet pavarësinë e këtij institucioni. Këto rekomandime, pjesa tjetër që nuk cenohen duhet të jenë të zbatueshme? Duhet të vëmë një detyrim këtu, sepse më duket shumë e hapur si pikë dhe në rast se ne nuk vëmë një detyrim për të respektuar detyrimet e Kuvendit që nuk cenohet pavarësinë e institucionit, rekomandimet ngelen formale.

**Fatmir Xhafaj** – Në respekt të pavarësisë të institucionit janë të detyrueshme për t'u shqyrtuar nga Këshilli. Kur del rezoluta e Kuvendit, duhet të mblidhet Këshilli dhe të shqyrtojë rezolutën.

Dakord me ndryshimin te pika 4.

Pika 3, kryetari ose një prej anëtarëve i deleguar i përgjigjet kërkesës për të paraqitur raportin. Kuvendi do të delegojë një njeri që të paraqitet?

**Gent Ibrahimi** – Në qoftë se është i sëmurë, sepse datën e cakton Kuvendi dhe ai mund të jetë i pamundur fizikisht. Vetëm në këtë rast.

**Fatmir Xhafaj** – E vendos Këshilli kë mund të caktojë, zëvendëskryetarin, dy anëtarë, tre anëtarë, por si rregull nuk delegon ai para legjislativit që të thotë unë nuk po vij vetë, por po dikë tjetër.

**Gent Ibrahimi** – Atëherë, ta formulojmë kështu, që në rast pamundësie të kryetari, këshilli cakton...

**Fatmir Xhafaj** – Nuk ka nevojë për detaje të tillë. As mund ta mendoj dot se si mund të mos vijë kryetari, sepse ne kemi pasur raste të ngjashme, kemi shtyrë mbledhjen për sa kohë që është bërë e mundur qenia e titullarit të institucionit. Dakordësohet midis Kuvendit, vetvetiu

krijohet një akordë se kur mund të bëhet seanca. S'mund të delegojë ai para Kuvendit dhe të thotë që po vjen një anëtar t'ju raportojë juve. Për mua aty duhet të jetë Këshilli, sepse në qoftë se kërkohet debat, në seancë plenare mund të marrë pjesë i gjithë Këshilli, në lozhë duke ndjekur seancën plenare, sepse Kuvendi rreth raportit mund të kërkojë debat. Këshilli i përgjigjet kërkesës së Kuvendit për paraqitjen e raportit për të gjitha pyetjet lidhur me të.

Dakord me ndryshimet në pikën tre dhe katër.

Neni 84, "Etika gjyqësore".

**Vasilika Hysi** –Është shtuar vetëm në paragrafin e parë pika c, që raporton publikisht për gjetjet.

**Fatmir Xhafaj** –Dakord me ndryshimin.

Faleminderit!

Neni 85, përcaktimi i kompetencave territoriale dhe madhësia e gjykatës.

**Vasilika Hysi** – Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vetëm një saktësim.

**Fatmir Xhafaj** – Po, dakord!

Neni 86, rekrutimi, emërimi i gjyqtarëve dhe propozimi i kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë.

**Vasilika Hysi**- Thjesht çështje redaktoriale.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord me nenin 86!

Neni 87, zhvillimi i karrierës dhe disiplina e gjyqtarëve.

**Vasilika Hysi** – Edhe këtu ka vetëm saktësime terminologjie.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord!

Neni 88, "Qëndrimet publike".

**Vasilika Hysi** – Zoti kryetar, nga mënyra se si është formuluar, nuk del qartë roli që luan Këshilli. I kam kërkuar ekspertëve të bëjnë një riformulim, sepse këtu fjala nuk është për çdo lloj shkeljeje, por thuhet "për çdo shkelje që gjyqtari beson se i është shkelur e drejta e tij, mund të kërkojë nga Këshilli një qëndrim publik". Këtu bëhet fjalë kur gjyqtari shantazhohet, bën presion.

**Fatmir Xhafaj** – Kjo duhet thënë që Këshilli me iniciativë të tij, ose me kërkesë të gjyqtarëve mund të mbajë qëndrime publike për këtë, pra vetë këshilli, sepse mundet të mbajë vetë këshilli.

Dakord për riformulimin!

Neni 89, trajnimi vazhdues i gjyqtareve.

**Vasilika Hysi** – Këtu ka saktësimet redaktoriale.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, saktësime redaktoriale për të pasur fjali të plota, sepse është trajnimi gjyqësor dhe për saktësi ju e keni bërë trajnimi vazhdues i gjyqtarëve.

Neni 90, administrimi i gjykatave.

**Vasilika Hysi** – Edhe këtu ka thjesht një saktësim te pika c, ku është shtuar fjala standarde ët gjykatës.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord me ndryshimin!

Neni 91, burimet njerëzore në gjykata.

**Vasilika Hysi** – Ekspertët kanë paraqitur nevojën për ndryshim të paragrafit të parë dhe të dytë.

**Fatmir Xhafaj** - Po, hiqet pika “v”, shikoj në këtë që kanë paraqitur ekspertët.

Jo ju lutem, e keni të paraqitur me shkrim, ku e keni? Sepse unë nuk mund të miratoj një gjë që nuk e kam fare.

**Gent Ibrahimi** - Ka një propozim për ta hequr paragrafin ekzistueses “dh”.

**Fatmir Xhafaj** – “Dh”-në e keni hequr fare?

**Gent Ibrahimi** – Dhe një saktësim te paragrafi ë.

**Fatmir Xhafaj** –Përveç kancelarëve dhe ndihmësve ligjorë? Ky është i gjithë ndryshimi?

**Gent Ibrahimi** – Po!

**Fatmir Xhafaj** – Hiqet germa “dh” dhe shtohet germa “ë”. Dakord, qenka fare e qartë. Hiqet edhe treshi?

**Gent Ibrahimi** – Po!

**Fatmir Xhafaj** - Dakord, faleminderit!

*(Ndërhyrje në anglisht)*

**Gent Ibrahimi** – Ka edhe diçka tjetër nga Agnes.

**Fatmir Xhafaj** – Po!

**Agnes Bernhard** – *(flet përkthyesi)* Duhet ta sqarojmë dhe ta kemi të qartë edhe nga ana ligjore që ka vetëm një regjistër qendror personeli dhe sugjerojmë që të ndryshojmë një fjalë, në vend të fjalës “administrim” të themi “popullim i regjistrimit qendror”.

**Fatmir Xhafaj** – Si?

**Agnes Bernhard** – *(flet përkthyesi)* Plotësimi, jo administrimi i regjistrimit qendror, por plotësimi, hedhja e të dhënave në regjistrin qendror të personelit. Gjithashtu formulimi te germa “e”, është pak jo i qartë. Duhet të fshijmë fjalët “punonjësit civil gjyqësor me përjashtim të të...” dhe ta shkruajmë “bashkëpunëtorët me Shkollën e Magjistraturës për trajnimin fillestar, **ashtu si dhe** të kancelarëve dhe ndihmësve ligjorë”.

**Fatmir Xhafaj** – Po, Etilda.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Mbylleni pak mikrofonin.

**Etilda Saliu** – Lidhur me regjistrin qendror të personelit, ne i kemi bërë këto dispozitat, si këtu edhe te projektligji për statusin e magjistratëve, në përputhje me sugjerimet e Departamentit të Administratës Publike.

Për sa kohë që ekziston një regjistër qendror personeli dhe është për të gjithë personat që marrin pagë nga buxheti i shtetit, administrohet nga DAP-i. Për këtë arsye nuk e lamë më që ky regjistër qendror personeli të administrohet nga Këshilli i lartë gjyqësor, por vetëm të hidhen të dhënat, të përditësohen dhe të kenë akses të plotë në përpunimin e gjithçkaje tjetër.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, me ndryshimet.

Faleminderit!

Neni 92 “Qasja në drejtësi dhe marrëdhëniet me publikun”.

**Vasilika Hysi** – Edhe këtu ka saktësime të vogla terminologjie.

**Fatmir Xhafaj** – Fjala “qasje”, germa “c” hiqet.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Në rregull, dakord me nenin 92, me ndryshimet.

Neni 93 sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve?

**Vasilika Hysi** – Ekspertët kanë sjellë një riformulim të një pike, konkretisht në lidhje me sistemin. I gjithë diskutimi është keqkuptimi që ka krijuar fjala “në përputhje me vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave”.

Ekspertët kanë një riformulim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Agnes Bernhard** – *(flet përkthyesi)* Ne do ta kemi këtë referencë që nga fillimi që kjo referencë të shoqërojë të gjithë ligjin. Do duhet të themi që në përputhje me vendimin përkatës të

Këshillit të Ministrave, Këshilli i Lartë Gjyqësor. Pas kësaj duhet të rendisim të gjithë paragrafët apo shkronjat.

Paragrafi 2 që është i ndarë në dy pjesë duhet të fshihet, që të jetë kështu më e qartë që ky referim i drejtohet të gjitha çështjeve.

**Fatmir Xhafaj** – në rregull.

Nuk është e nevojshme që të... se gjithë këtë keqkuptim e ka krijuar fjala “me vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave”, këtu janë me politikat shtetërore në fushën e informacionit dhe sigurisë së informacionit.

Ky duhet të jetë në një fjali të përgjithshme, nuk ka nevojë të thuhet pastaj... Por politika shtetërore që në fillim. Politikat shtetërore i bën qeveria, se duke thënë këtu fjalët: “me vendimet” është sikur do të vendosi këshilli për këtë gjë. ndajeni në pikë më vete këtë gjë dhe thoni: në përputhje me politikat e përgjithshme të teknologjisë së informacionit dhe sigurisë së informacionit.

Se ka... Janë strategji dhe politika të unifikuara për këtë gjë.

Dakord, me ndryshimin.

Neni 94 “Mendime mbi legjislacionin”.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

A nuk mund t’i përmbliidhni këto ju në fund fare, të gjitha këto mendime mbi legjislacionin që të jenë edhe për Këshillin e prokurorisë, edhe për të gjitha këto të jenë bashkërisht, se kështu do t’ju duhet t’i replikoni pastaj atje tek ajo tjetra?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Në rregull.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Urdhëroni?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Mendime...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Opinione ose kontribute për procesin legjislativ.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Opinione po.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Jo, jo, thelbin nuk e ndryshon, por është e drejtë!

Duhet çuar të gjitha në fund, sepse do t'i bëni edhe te prokuroria.

Të gjithë këta japin mendime, japin opinione për organet e sistemit të drejtësisë përmes ministrit të drejtësisë e të tjera.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Dhe i japin të gjitha, nuk është se ka edhe Këshilli i Prokurorisë. Një kanë dhe këtë nuk e përmendin në çdo paragraf.

Dakord Genti?

**Gent Ibrahimi** - Dakord.

**Fatmir Xhafaj** - Dakord edhe zoti Ibrahimi me këtë ide.

Jo këshilli mund t'i kërkojë ministrit, por ai i propozon ministrit. Siç ndodh sot me Këshillin e Lartë të Drejtësisë.

Dakord.

Neni 95. Rregullat e brendshme të gjykatave.

Është futur kryesisht fjala “standarde”, rregulla standarde, veprime standarde.

Dakord?

Dakord për nenin 95, me ndryshimet e teknikës.

Neni 96. Buxheti vjetor i këshillit dhe i gjykatave.

**Vasilika Hysi** - Zoti kryetar, këtu është lënë një pikë e hapur. Është kërkuar një mendim nga Ministria e Financave, sepse në pikën 3 thuhet, që në çdo rast, dyshemeja e programit buxhetor afatmesëm për financimin e sistemit të drejtësisë, nuk mund të jetë më pak se 1% e shpenzimeve buxhetore.

**Fatmir Xhafaj** - Hiqeni këtë, sepse nuk vëmë kufij në programe. Dakord.

**Etilda Saliu** - Është e vërtetë që i kemi bërë një kërkesë Ministrisë së Financave për të parë nenin 96 dhe ata na kanë sjellë riformulimin, por ndërkohë, lidhur me përcaktimin e bërë, për vendosjen e masës 1%, ata shprehen kundër, pasi bie në kundërshtim me parimet buxhetore.

**Fatmir Xhafaj** - Po pra, dakord.

**Etilda Saliu** – Përveç kësaj, kanë sjellë edhe riformulimin e tekstit të riparë. Në rast se mendoni që duhet të lexojmë ndryshimet....



**Fatmir Xhafaj** - Reflektojani sipas asaj që keni rënë dakord me Ministrinë e Financave. E rëndësishme është që të jetë një tekst i unifikuar për të gjitha rastet e krijimit të buxhetit. Dakord me nenin 96.

Çfarë është kjo? Këshilli mund të pranojë fonde nga dhurues, me kushtin që të mos ketë konflikt interesi midis dhuruesit dhe veprimtarisë së keshillit, në lidhje me projekte që përfshihen në programin e buxhetit të keshillit për vitin përkatës financiar apo projektet e reformës gjyqësore që nuk janë të përfshira në buxhetin e shtetit.

Të lutem Edlira mbaje shënim, sepse dua ta rishikoj nenin 96. Ajo duhet thjeshtuar me 2-3 paragrafë. Dakord?

Edhe një herë. Duhet të kuptojmë se Këshilli i Lartë Gjyqësor është organ shtetëror, nuk është organizatë joqeveritare. Po

**Etilda Saliu** - Të gjithë nenin 96, e ka riformuluar Ministria e Financave në 5 paragrafë të shkurtër dhe të qartë.

**Fatmir Xhafaj** - Dakord, por gjithsesi të mbetet te nenet, që duhet t'i rishikojmë para votimit në tërësi.

Neni 97. Zbatimi i buxhetit gjyqësor.

Edhe këtë besoj se e keni riparë?

**Vasilika Hysi** - Zoti kryetar, te pika 5, ku flitet për krijimin e fondit rezervë deri në 2% të fondeve buxhetore të miratuar nga gjykata, ka një problem. U kam kërkuar ekspertëve një mendim të Ministrisë së Financave, por nuk e di nëse ka ardhur?

**Etilda Saliu** - Këtu nuk ka ardhur ende. Mbetemi në pritje.

**Fatmir Xhafaj** - Dakord.

**Vasilika Hysi** - Fjalia e fundit Fatmir.

**Gent Ibrahim** - Neve në Komisionin *ad hoc* na ka ardhur si frazë nga grupi i financimit, kështu që ne nuk e kemi diskutuar, por thjesht e kemi marrë prej tyre dhe e kemi futur këtu.

**Fatmir Xhafaj** - Dakord.

**Petrit Vasili** - Për sa u takon pjesëve të buxhetit, kudo ka vend për krehje, sepse vijnë disa formulime të cilat mund ta bëjnë objekt komentesh. Tani, të themi që ndihmon gjykatën në hartimin e projektbuxheteve, kjo nuk shkon. Dihet, që po që se është një organ i centralizuar, që

ka një rregull, harton një buxhet integral ku janë edhe pjesë të gjykatave përkatëse. Ka disa rregulla në hartimin e kësaj pune. E para kjo.

Së dyti, mbledh dhe analizon të dhëna për zbatimin e buxhetit. Kjo nuk shkon. Monitoron zbatimin e buxhetit është detyra e saj funksionale. Ka një fjalë të vetme. Njëkohësisht, mbikëqyrë dhe këshillon gjykatën mbi teknikat dhe procedurat e përshtatshme dhe eficiente, të cilat lidhen me menaxhimin financiar të tyre. Edhe kjo nuk shkon. Rregullat se si menaxhohet buxheti, s'ka rëndësi fare se i kujt është, ministri apo gjykatë, janë të përcaktuara. Këtu do përcaktime shumë të thjeshta që shkojnë sipas standardit që është vendosur. Ka shumë parazitizma që nuk i shkojnë dhe e bëjnë sikur ky është një organ, por ato janë të tjera... Domethënë ka një marrëdhënie kaq fakultative sa s'ka. Marrëdhëniet e buxhetit janë marrëdhënie detyruese dhe kjo i detyrohet një gjuhe të ftohtë..., pjesët e tjera janë pjesë e saj. Nuk i themi dot ne ndihmo apo edhe gjëra të tjera. Nuk dua që ta marr nenin nga fillimi deri në fund, por disa krehje janë shumë të domosdoshme për t'u bërë, ashtu siç e ka detyrë edhe ky nen.

**Fatmir Xhafaj** - Edhe kjo duhet riformuluar, sepse është shumë e hollësishme.

Kam një pyetje: Do kenë rregullore këshilli dhe komisionet e këshillit?

Do kenë një rregullore të brendshme, apo jo?

Atëherë, të gjitha këto janë pjesë për rregulloren, se si ai i studion dhe përcakton nevojat. Mjaft që të përcaktohet në ligj, se detyrimi i tij kryesor është që të merret me hartimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit. Pastaj, se si e bën ai këtë me kryetarët e gjykatave dhe me të tjerë, këtë vendoseni në rregullore, sepse edhe lehtësohet dhe nuk....Dakord?

Dakord Etilda, meqenëse po merresh me buxhetin? Sot duhet diskutuar edhe kjo me këta të financave.

Faleminderit!

Kalojmë te neni 98. Aktet e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Nuk kemi gjë këtu.

Dakord.

Neni 99. Njoftimi dhe botimi i akteve të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Vasilika Hysi** – Zoti kryetar, këtu ka vetëm një shtesë te paragrafi i tretë...

**Fatmir Xhafaj** - Këto akte hyjnë në fuqi, në datën e botimit në faqen zyrtare të këshillit. Dakord me nenin 99.

Neni 100. Procedura e shqyrtimit.

Po, janë thjesht saktësime fjalish. Dakord.

Neni 101. Ankimi i vendimeve të këshillit.

Dakord me saktësimet në nenin 101.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

Këtu ka një propozim të paraqitur nga opozita, për ta replikuar të gjithë këtë që bëmë për Këshillin e Lartë Gjyqësor, natyrisht, duke nxjerrë më vete disa dispozita të përbashkëta siç janë këto të buxhetit, të marrëdhënieve institucionale me ministrin, me Kuvendin. E gjitha pjesa e gjyqësorit, për të mos pasur keqkuptime në interpretimin... Krijojmë një organ të ri shumë të rëndësishëm për prokurorinë, por përsëri e varim atë nga pikëpamja se duhet të bëjë interpretime për funksionet e veta. Këtu bie dakord me propozimin e opozitës dhe besoj se edhe kolegët janë dakord. Besoj se edhe zonja Benhard, me të cilën kam diskutuar, është dakord për ta nxjerrë kapitull më vete Këshillin e Lartë të Prokurorisë, siç trajtuam Këshillin e Lartë Gjyqësor. Jo me referenca, sepse mund të krijojnë keqkuptime. Ne po krijojmë një institucion të ri, qeverinë ekzekutive të prokurorit, plus që ka një marrëdhënie shumë specifike me prokurorin e Përgjithshëm. Duhet të jemi shumë të kujdesshëm, sepse mund të kenë konflikte midis tyre, sepse Këshilli i Lartë Gjyqësor, nuk ka një figurë të replikuar, siç është prokurori i Përgjithshëm dhe drejtuesi i SPAK-ut.

Pra, janë dy- tri figura shtesë që kanë nevojë të qartësohen në marrëdhëniet dhe kompetencat e këshillit, që ia ka dhënë ligji për prokurorinë. Gjithashtu, këtë duhet ta mbyllim para se të mbyllim ligjin e prokurorisë dhe SPAK-ut, në mënyrë që mos të kemi ndonjë përplasje për këtë gjë.

Dakord? E di që është e vështirë dhe që do shtohet pak puna për ju sot pasdite, por besoj se prandaj jeni të frymëzuar për ta mbyllur këtë.

Dakord?

Të lutem, në të dy këto, duhet vendosur që këto miratojnë rregulloren e tyre të brendshme. Të kenë të dy organet rregulloren e brendshme, ku përcaktohen detyrat specifike për komisionet që ta kenë detyrim rregulloren. Të kenë një rregullore të brendshme të funksionimit të tyre të bazuar në ligj.

Pjesa e tretë.

Inspektorati i Lartë i Drejtësisë.

Inspektori apo Inspektorati?

**Gent Ibrahim** - Organi kushtetues është inspektori, kështu që besoj se duhet të jetë inspektorati.

**Fatmir Xhafaj** - Organi është i inspektorit, por kur i drejtoheni më pas, diku thoni inspektori kurse diku tjetër thoni inspektorati. Apo do thoni zyra e inspektorit?

**Gent Ibrahim** - Po. Në fakt, kjo do të ishte më korrekte, që kudo që flitet për inspektorat të flasim për zyra inspektori.

**Fatmir Xhafaj** - Siç veprojmë sot me zyrën e prokurorit të Përgjithshëm. Dakord për ta unifikuar terminologjinë, sepse e ndesha disa herë gjatë leximit.

Dakord për nenin 103.

Neni 104. Objekti...

Do ndryshojnë nenet. Me futjen e neneve të prokurorisë, natyrisht që këto do të numërtohen ndryshe, por gjithsesi unë po i lexoj siç janë aktualisht.

Neni 104. Objekti i veprimtarisë së inspektorit.

**Vasilika Hysi** - Zoti kryetar. Në këtë nen ka disa saktësime lidhur me formën e ankimimit, duke shtuar ankimimin me shkrim. Kemi shtuar ankimimin e prokurorit të Përgjithshëm dhe paragrafi i tretë është riformuluar: “Inspektori i lartë i heton shkeljet e dyshuara edhe kryesisht, bazuar në të dhënat publike ose të siguruar në kuadrin e inspektimeve institucionale, tematike, sipas kushteve dhe procedurave të parashikuara në ligjin për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit, kurse paragrafi i katërt ka riformulime të teknikës.

**Fatmir Xhafaj** - Mund të vendosim diçka këtu për komisionet hetimore të Kuvendit, sepse shpeshherë ato kanë çështje për organet...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Dakord me nenin 104, me ndryshimet e paraqitura që kryesisht janë të teknikës legjislative.

Neni 105. Parimet themelore dhe procedurat e veprimtarisë dhe organizimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Mund ta lini shkurt fare këtë: Parimet themelore dhe procedurat e veprimtarisë. Nuk ka nevojë për inspektorin, sepse kuptohet.

Keni ndonjë riformulim të këtij neni zoti Ibrahim?

Po, zonja Bernhard.

**Agnes Bernhard** - *(flet përkthyesi)* Këtu mund të kemi një titull tjetër, duke futur edhe ligjin e aplikueshëm që lidhet me teknologjinë e informacionit.

**Gent Ibrahimi** - Do ta rishikojmë titullin.

**Fatmir Xhafaj** - Dakord.

**Vasilika Hysi** - Ekspertët kanë bërë një sugjerim për të fshirë të gjitha parimet që renditen në paragrafin e dytë. Do doja të dëgjoja arsyen se pse e kanë fshirë.

**Gent Ibrahimi** – Gjithashtu, ky ishte një propozim nga Euralius-i, sepse këto parime jepen edhe te ligji për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit. Duke qenë se këtu janë të formuluar disa ndryshe, rrezikonim që të kishim një lloj konfondimi...

**Fatmir Xhafaj** - A mund t’u referoheni....

**Gent Ibrahimi** - Po, besoj se mund t’u referohemi, sepse inspektori inspekton në bazë të atyre procedurave. Pra, inspektimi është një nga aspektet...

**Fatmir Xhafaj** - Dakord me të gjitha ndryshimet në nenin 105.

Neni 106. Pavarësia.

**Vasilika Hysi** - Nuk ka ndonjë riformulim substancial, por thjesht një shtesë të shprehjes “shkakton përgjegjësi” sipas ligjit në fund...

Dakord.

Neni 107. Buxheti dhe struktura e Inspektoratit.

**Vasilika Hysi** - Te paragrafit i dytë ka një shtesë lidhur me projektbuxhetin e propozuar nga inspektori, i cili lihet në dispozicion të Kuvendit.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord?

Dakord. Faleminderit!

Neni 108. Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

**Vasilika Hysi** - Personalisht nuk kam ndonjë gjë.

**Gent Ibrahimi** - Në fakt, këtu ka diçka që e ka konstatuar opozita. Kushtetuta flet për një **stad** të inspektorit të lartë, të barabartë me atë të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, kurse në tekst, në raundin e fundit të ndryshimeve, ne e kemi shkruar “kryetari i Gjykatës së Lartë”, kështu që kjo duhet të korrigjohet sipas vërejtjes së opozitës.

**Fatmir Xhafaj** - Si e ka...

**Gent Ibrahimi** - Kushtetuta thotë, që inspektori i lartë ka statusin e anëtarit të Gjykatës së Lartë, kurse ne këtu kemi thënë të kryetarit të Gjykatës së Lartë dhe kjo sipas Kushtetutës duhet të ndryshohet. Pra, ka statusin e anëtarit të Gjykatës së Lartë.

**Fatmir Xhafaj** - Edhe pagën e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

**Gent Ibrahimi** - Po.

**Fatmir Xhafaj** – Kryeinspektori.

**Gent Ibrahimi** – Po

**Fatmir Xhafaj** - Është korrekte.

Dakord.

Paragrafi i parë. Ka pagën dhe përfitimet e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

Dakord?

Faleminderit!

Po.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Të lutem, a mund të kujdesesh herë pas here për mikrofonin e zonjës...

**Etilda Saliu** - Kam një ndërhyrje për nenin 107 që nuk arrita ta bëja në kohë. Gjithashtu, Ministria e Financave ka dhënë dy komente për mënyrën e buxhetit dhe strukturës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke shtuar te paragrafi i parë: “i cili është pjesë e buxhetit të shtetit të miratuar nga Kuvendi” dhe te paragrafi i dytë, sugjeron që të hiqet fjalia e dytë ku thuhet: “në rastet kur projektbuxheti i inspektorit që paraqitet nga Këshilli i Ministrave në Kuvend, është i ndryshëm nga projektbuxheti i propozuar nga inspektori i lartë, projektbuxheti i propozuar nga inspektori, i vihet në dispozicion Kuvendit”. Ministria e Financave sugjeron që këtë përcaktim ta heqim dhe njëkohësisht kërkon që përcaktimin e paragrafit të katërt ta rishikojmë.

**Gent Ibrahimi** - Mendoj se kjo është një nga standardet e reja që fut kjo reformë për buxhetin e institucioneve...

**Fatmir Xhafaj** - Dakord me ndryshim të pikës së parë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Po pra, e thamë. Pika 2 do qëndrojë siç është.

Nenin 108 e kaluam. Nuk kishte ndryshime, vetëm çështjen e barazisë në pagë me gjyqtarin.

Neni 109. Kushtet e emërimit.

**Vasilika Hysi** - Sugjeroj që të shtohet diçka. Unë mendoj që nuk mund të jetë inspektor një person që më parë është pushuar nga puna për shkaqe disiplinore. Ky është propozimi. Pra, nuk është pushuar nga puna më parë për shkaqe disiplinore dhe nuk ka masa disiplinore në fuqi

në momentin e kandidimit. Të shtohet kriteri që nuk është bashkëpunëtor informator dhe agjent i shërbimeve të inteligjencës, por edhe nuk ka qenë më parë.

Pastërtia e figurës dhe e integritetit. Njëkohësisht duhet të shikojmë pikën 2, referencën, te kriteret objektive që parashikon ligji. Tani, me splotimet që bëhen për shkak të shtesave, këtu e kam për stafin, pjesën tjetër pastaj... Nuk e di, por edhe në mbledhjet e mëparshme zoti kryetar, unë kam thënë që këto kriteret janë shumë pak për një inspektor të lartë të drejtësisë. Janë bazike.

Pra, të ketë 15 vjet përvojë pune në profesionin si jurist, të mos jetë i dënues për një veprë penale, të mos ketë një masë disiplinore, dhe të mos ketë bashkëpunëtorë, mua më duken pak. Ndonëse në nenin 149 ka disa kriteret shtesë, por ndoshta duhet të qartësohet që çdo njeri që do të kandidojë... ne kemi thënë në titull “kushtet dhe kriteret”. Çdo njeri duhet të përmbushë kushtet dhe kriteret.

**Fatmir Xhafaj** - Mos e keni hequr fjalën “kriteret”.

Ku i keni kriteret shtesë pastaj?

**Gent Ibrahim** - Në rastin e Inspektorit, inspektori është funksionari i vetëm dhe nga të paktit që ka mbetur për t’u shqyrtuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi. Atje ka një nen shumë të qartë me kriteret që do duhet të plotësojnë, kështu që në këtë rast, ne mund t’i lejojmë vetes luksin të flasim vetëm për kushtet ligjore, të cilat nuk mund të jenë shumë, sepse janë shumë të përgjithshme. Ky nen duhet lexuar së bashku me nenin 151, i cili detajon kriteret.

**Fatmir Xhafaj** - Po, kushtet e emërimit, kurse kriteret do jenë atje.

Ka të drejtë në parim zonja Hysi, kështu që duhet të jetë e vëmendshme kur të arrijmë tek ai nen. Dakord?

Dakord me ndryshimet në nenin 109.

**Vexhi Muçmataj** – Germa “b”. Me përvojë pune në profesion jo më pak se 15 vjet. Çfarë profesioni?

**Fatmir Xhafaj** - Si jurist.

**Vexhi Muçmataj** - Po pra, duhet specifikuar.

**Fatmir Xhafaj** - Po, është shtuar, e lexoi zonja Hysi. Keni të drejtë, te germa “b” të shtohet shprehja “si jurist”.

Dakord me ndryshimet në nenin 109.

Neni 110. Papajtueshmëria.

Është vetëm një saktësim në germën “c”. Veprimtari private në kuadrin e subjekteve tregtare.

**Fatmir Xhafaj** - Dakord me nenin 110.

Neni 111. Përzgjedhja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

**Vasilika Hysi** - Duhet të jemi të kujdesshëm te referenca që bëhet në germën “g” të kriteret, për të cilat sapo folëm dhe mbi të cilat vendos këshilli. Pra, duhet të rregullojmë referencat, bazuar edhe në ndryshimet....

Dakord me ndryshimet në nenin 111.

Neni 112. Betimi dhe fillimi i detyrës.

Dakord.

Neni 113. Mandati i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

**Vasilika Hysi** - Ka një rregullim në paragrafin e dytë, ku do thuhet: “pas përfundimit të mandatit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në qoftë se në momentin e zgjedhjes punonte me kohë të plotë në sektorin publik, ka të drejtë të rikthehet në vendin e mëparshëm të punës ose në pamundësi, në një detyrë të barazvlefshme me të”.

**Fatmir Xhafaj** - Në Kushtetutë ne e kemi me 9 vjet këtë apo jo?

Dakord. Mund të ketë qenë gjyqtar më parë, por përsëri gjyqtar do kthehet?

Në qoftë se ai ka qenë gjyqtar në shkallë të parë, do kthehet përsëri gjyqtar në shkallë të parë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Të lutem, ka qenë gjyqtar në shkallë të parë, dhe pas 9 vjetësh kryeinspektor....

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Meqenëse ka punuar në sistem, minimalisht gjyqtar, apo prokuror në prokuroritë e rretheve, të apelit ose në gjykatë apeli.

Dakord?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Do ta vendosim, që kur është gjyqtar dhe prokuror, minimalisht shkon në këtë nivel. Janë të detyruar ta kthejnë atje, sepse ai është kryeinspektor i...

Ky është një nga njerëzit më të rëndësishëm që do të ketë sistemi dhe jam shumë dakord me zonjën Hysi, që duhet të ketë kriterë shumë më të forta. Keni bërë një super, super, super organ me kriterë të dobëta, zonja Benhard.



**Gent Ibrahim** - Kur të arrijmë te neni 151 do të...

**Fatmir Xhafaj** - Do të bindemi ne? Faleminderit për ndërhyrjen tuaj bindëse.

Neni 114. Kompetencat e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

**Vasilika Hysi** - Në fakt, duhet të rregullohet nëse mund të japë udhëzime detyruese apo jo, në lidhje me çështjen konkrete.

**Fatmir Xhafaj** - Edhe unë e kam shënuar germën “ç”, që do të thotë se nxjerr udhëzime jodetyruese në lidhje me çështje konkrete.

**Gent Ibrahim** – Në një farë mënyre, ky është thelbi i këtij institucioni. Ky është një institucion i centralizuar, kështu e do Kushtetuta, megjithatë, ky ligj në një farë mënyre e zbut centralizmin e këtij institucioni. Nuk i jep mundësinë inspektorit të lartë që të urdhërojë inspektorin, por ama duke qenë se në fund të fundit ai është një institucion i centralizuar, ka të drejtën t'i thotë që unë mendoj që këtë çështje ti duhet ta zgjidhësh kështu. Në rast se inspektori nuk bie dakord, prevalon vendimi i prokurorit të lartë...

**Fatmir Xhafaj** - Kjo është e qartë, por kjo më poshtë.

**Gent Ibrahim** - ... dhe thjesht të dyja opinionet i shkojnë organit disiplinor.

**Fatmir Xhafaj** - Ndoshta do një formulim më elegant për çështjen konkrete të trajtuara nga inspektorët. Pra, ideja është se çështja konkrete duket si çështje gjyqësore. Më kupton? Për **kauzisin** është fjala?

Dakord me këto ndryshime.

**Vasilika Hysi** - Edhe diçka tjetër zoti kryetar. Te paragrafi i katërt i këtij neni, “udhëzimet apo objeksionet e inspektorit të lartë”, mendoj që ta rregullojmë: “argumentet e mëtejshme të inspektorit”, bëhen pjesë e dosjes.

Kur jep një udhëzim, patjetër që duhet të japë edhe argumentet pse.

**Fatmir Xhafaj** - Dakord. Miratohet me këto ndryshime neni 114.

Neni 115. Zëvendësi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

**Vasilika Hysi** - Është bërë një rregullim i referencës, por tani, me shtesat që do bëhen ndoshta ka ndryshime të mëtejshme, kurse pjesa tjetër janë saktësime të termave nga pikëpamja e teknikës.

**Fatmir Xhafaj** - Dakord?

Faleminderit!

Neni 116. Mbarimi i mandatit.

**Vasilika Hysi** - Ka vetëm saktësim terminologjie te pjesa e shëndetit mendor.

**Fatmir Xhafaj** - Dakord me nenin 116.

**Gent Ibrahim** - A mund të kthehem pak te neni 114, sepse në qoftë se ideja jonë ka qenë, që në rastet kur ka një diskordancë midis inspektorit të lartë dhe inspektorit, mendimi i këtij të parit do të duhet të prevalojë në fund. Kjo nuk ka dalë shumë e qartë këtu. Ne flasim për udhëzime jodetyruese në lidhje me çështje konkrete, por në rast se inspektori, nuk i merr parasysh këto udhëzime në çështjen konkrete, në fund inspektori ka të drejtën ta ndryshojë vendimin e inspektorit. Edhe kjo nuk ka dalë shumë e qartë, ndonëse ka qenë ideja jonë, kështu që me lejen tuaj, dua ta sqaroj.

**Fatmir Xhafaj** - Dakord. Reflektojeni te neni përkatës.

Neni 115 dakord.

Neni 116. Mbarimi i mandatit.

Dakord.

Neni 117. Shkeljet disiplinore.

Dakord.

**Vasilika Hysi** - Në fakt, zoti kryetar, unë kam një shqetësim. Meqenëse ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve e kemi në dorë, duhet parë në raport me ligjin dhe kompetencat, siç janë përmendur këtu. Nuk e di se cilat janë ndryshimet që ka pësuar ligji për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit pas komenteve që ne kemi bërë, pasi shkeljet disiplinore janë të rregulluara edhe në ligjin e statusit.

**Fatmir Xhafaj** – Po.

**Gent Ibrahim** - Kemi edhe një lapsus te paragrafi i fundit i nenit 116, ku flasim për mbarimin e mandatit të inspektorit të përgjithshëm që e deklaron Kuvendi. Në fakt, Kushtetuta thotë që e deklaron mbledhja e përbashkët e KLP-së dhe KLGJ-së. Është një lapsus që duhet korrigjuar.

**Fatmir Xhafaj** - Dakord. Ishalla keni sa më pak të tilla.

Po.

Neni 118. Hetimi i shkeljeve disiplinore. Kemi gjë për nenin 118?

**Vasilika Hysi** - Neni 118 ka ndryshime. Është misioni Euralius, ai që ka sjellë një sërë ndryshimesh të këtij neni, por njëkohësisht janë marrë në konsideratë edhe sugjerimet që kemi bërë ne në komision. Po t'i marrim me radhë paragrafët...

**Fatmir Xhafaj** - Ne e kemi këtu tekstin..

**Vasilika Hysi** – E pra, mund të shikoni tekstin përpara....

**Fatmir Xhafaj** - Përderisa e kemi tekstin përpara për këto ndryshime.... vetëm ku ka kontestime.

**Vasilika Hysi** - Janë të gjitha reflektimet e bëra pas komenteve që ka bërë edhe misioni Euralius.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord?

Dakord me ndryshimet e propozuara. Faleminderit!

Neni 119. Kushtet për emërimin e inspektorit.

Dakord.

**Vasilika Hysi** - Ka përsëri shtesa nga Euralius-i. Shtohen paragrafët 3, 4,...

**Fatmir Xhafaj** - Komiteti i Emërimit të Vlerësimit.

Dakord sipas tekstit, meqenëse i kemi këtu me shkrim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Ka të drejtë.

Po.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Po dakord.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Urdhëro?

Dakord me ndryshimet e paraqitura, sidomos me paragrafët 3 dhe 4, të shtuar.

Neni 120. Statusi i inspektorëve.

**Vasilika Hysi** - Zoti kryetar, këtu nuk ka gjetur zgjidhje një shqetësim që ne e kemi ngritur të gjithë bashkë në mbledhjen e parë. Në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë do të ketë dy kategori inspektorësh, inspektor magjistratë dhe inspektorë jomagjistratë. Nja nga shqetësimet që ka ngritur në vendimin e vet Ministria e Financave, është që ndarja e inspektorëve në dy nivele sjell një diskriminim të madh në paga, sepse të dyja kategoritë e inspektorëve, si magjistratë dhe jo magjistratë do të bëjnë të njëjtën punë, por paga e tyre është 1 me 2. Pra, për të njëjtën punë kanë paga të ndryshme dhe ky diferencim në pagë vjen për shkak të statusit që ata kanë. Personalisht nuk flas dot, se nuk e di gjendjen se sa mund të ofrohet, që të gjithë inspektorët të kenë statusin e magjistratit. Pra, aktualisht, kemi dy kategori magjistratësh që

rregullohen me statute dhe ligje të ndryshme. Njëri me Statusin e Nëpunësit Civil, kurse tjetri ka statusin e gjykatësit të Gjykatës së Lartë.

**Fatmir Xhafaj** – Po.

Zoti Ibrahim.

**Gent Ibrahim** - Te paragrafi i parë i këtij neni, do duhet të bëhet ndryshimi që diktohet... gjyqtari i apelit. Në këtë rast, statusi nuk ka ndonjë diferencë të madhe, sepse ke një sekretar të Përgjithshëm në administratë, kështu që janë pak a shumë njësoj, në mos njësoj.

**Fatmir Xhafaj** - Faleminderit për këtë ndryshim te paragrafi i parë, i cili e zgjidh shqetësimin e zonjës Hysi!

Vazhdojmë me nenin 121. Rekrutimi i inspektorëve.

Dakord me ndryshimet e bëra?

Dakord.

Neni 122. Vlerësimi i veprimtarisë etiko-profesionale.

Futet komisioni i emërimit dhe vlerësimit që u fut në nenin e mëparshëm.

Dakord.

Neni 123. Shkeljet disiplinore të inspektorëve të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë.

Futet përsëri si logjikë “anëtarët e komisionit disiplinor”, meqenëse e pranuar më lart.

Dakord.

Neni 124. Detyrat e inspektorëve.

**Agnes Bernhard** -(flet përkatësi) Unë këtu doja të bëja një vërejtje. Vendimet për shkelje disiplinore të anëtarëve të komisionit, nuk do të merren nga inspektori i përgjithshëm apo i lartë. Na falni, sepse kishim një version ndryshe nga ai që po diskutonit, prandaj mos e merrni parasysht.

**Fatmir Xhafaj** - Dakord me nenin 123 me ndryshimet që kemi në tekst.

Faleminderit!

Neni 124. Detyrat e inspektorëve. Po. Mbyllini mikrofonat ju lutem!

Klodi...

Shumë faleminderit!

**Vexhi Muçmataj** – Te neni 124, pika 2, të krijohet mendimi se inspektorët merren vetëm me shkeljet disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

**Fatmir Xhafaj** – Çfarë?

**Vexhi Muçmataj**- Të krijohet mendimi se inspektorët merren vetëm me shkeljet disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve. A kanë detyra të tjera këta në inspektim?

**Fatmir Xhafaj** – Po shkeljet disiplinore kanë ata, nuk kanë tjetër.

**Vexhi Muçmataj** - Më fal, shkelja disiplinore natyrisht kur evidentohet, por ka raste që ajo nuk evidentohet.

**Fatmir Xhafaj** – Po.

**Vexhi Muçmataj** – Por ka raste që ajo nuk evidentohet, për shembull, ka zvarritje në gjykimin e një çështjeje...

**Fatmir Xhafaj** – Por bëjnë inspektime tematike ata.

**Vexhi Muçmataj** – Pikërisht, por mos duhet saktësuar kjo dispozitë?

**Fatmir Xhafaj** – E kanë më duket.

**Vexhi Muçmataj** – Sepse ka kërkesa/ankesa nga subjektet procedurale...

**Fatmir Xhafaj** – Po.

**Vexhi Muçmataj** - ...në hetim, në gjykim. E kupton? Kush do t'i shqyrtojë këto?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Fatmir Xhafaj** – Po, zoti...

**Vexhi Muçmataj** – Pikërisht, ne duhet ta zgjerojmë objektin e punës.

**Fatmir Xhafaj** – Po, po.

**Vexhi Muçmataj** – Për çështje që nuk kanë të bëjnë me themelin e problemit...

**Gent Ibrahimi** – Patjetër.

**Vexhi Muçmataj** – Prandaj, duhet ta zgjerojmë.

**Fatmir Xhafaj** – Po, zoti Ibrahimi.

**Gent Ibrahimi** – Pa dyshim që...

**Fatmir Xhafaj** – Se ata kanë të bëjnë vetë, por u kërkon edhe ministri i Drejtësisë inspektime tematike...

**Vexhi Muçmataj** – Duhet saktësuar ajo.

**Gent Ibrahimi** – Këta hetojnë të gjitha ankimet dhe pak a shumë janë funksionet që kryen sot Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që heton ankesat, bën hetime me nismë për shkelje të prezumuar disiplinore, si edhe bën inspektime tematike për çështje të ndryshme: si funksionon...

**Fatmir Xhafaj** – Mirë pra, por këtu nuk është shumë e qartë, ndoshta inspektimet tematike.

**Gent Ibrahimi** – Se këto, në fakt, janë detyrat e inspektorëve si individë, nuk janë detyrat e institucionit. Nuk mund të thuash që inspektori bën inspektimin tematik, atë e bën inspektorati.

**Fatmir Xhafaj** – Po, ato janë më lart tek inspektorati...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Gent Ibrahimi** – ..arsye, sepse nuk del këtu, por të jeni të sigurt që kjo kompetencë është brenda këtij institucioni.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull. Faleminderit!

Dakord me ndryshimet te neni 124

Neni 125. Administrata e inspektoratit, administrata e zyrës së inspektorit, si do ta formuloni.... Dakord.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Po?

**Vasilika Hysi** – Ju kërkoj shumë ndjesë, Genti, por te statusi i inspektorëve, ju thatë që duhet të kenë pagën e gjyqtarit të Apelit.

**Fatmir Xhafaj** – Po.

**Vasilika Hysi** – Por, te neni 119, ju thoni që kandidatët për inspektor, në kohën e kandidimit, pika 5, germa “a” duhet të plotësojnë kushtet për t’u emëruar në Gjykatën e Lartë dhe në Prokurorinë e Përgjithshme.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Gent Ibrahimi** – Mendoj se kjo mund të mbetet, në qoftë se do të duam të marrim ajkën e tyre. Nuk është e thënë të korrespondojë me trajtimin që do të marrin kur të shkojnë atje, por që të kenë kushtet. Për shembull, të kenë qenë gjyqtarë Apeli për x vjet, aq sa duhen për të kandiduar për në Gjykatën e Lartë... Megjithatë, mund edhe ta unifikojmë.

Mendoj se e mira është që këtu të kemi filtra të lartë, në mënyrë që të marrim ajkën e gjyqtarëve, të paktën e atyre që vijnë nga radhët e magistratëve. Nuk është e domosdoshme që ta rakordojmë me statusin që do të kenë kur të shkojnë atje, por megjithatë edhe mund ta bëjmë. Kjo është ideja.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Jo, nuk ka problem.

Neni 125. Administrata..., Dakord.

Neni 126. Sistemi i menaxhimit të çështjeve.

**Vasilika Hysi** – Euralius-i ka sjellë një...

**Fatmir Xhafaj** – Siç e kemi këtë formulimin këtu...

**Vasilika Hysi** – Po, një formulim të ri të të gjithë nenit.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 1: “është përgjegjës për zhvillimin ose pjesëmarrjen në zhvillimin e...”.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

...për përdorimin. Pika 1, detyrat e inspektoratit. Dy pikat që janë. Dakord?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Siç janë paraqitur?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Zyra e inspektorit? Dakord?

Dakord. Faleminderit!

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi. Po.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Po, po, po!

Më vjen keq, ju lutem!

**Ulsi Manja** – Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka të drejtën që të fillojë me iniciativë hetimin e shkeljeve disiplinore?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Fatmir Xhafaj** – E ka që në hyrje.

**Ulsi Manja** – Në rregull.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Fatmir Xhafaj** – E ka që në hyrje të kapitullit, si edhe në Kushtetutë: “Ai kryen hetime administrative me iniciativë”. Del një rast në media, çfarë do të bëjë ai, do të presë t’i shkojë ankesa. Apo jo?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Saktë!

Dakord, faleminderit!

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.

Po, urdhëroni!

**Agnes Bernhard** – *(flet përkthyesi)* Në lidhje me sistemin e menaxhimit të çështjeve, kjo është një pikë ku ne ndoshta nuk kemi rënë dakord plotësisht. Ne duam një qendër të përbashkët për të gjitha organet e sistemit të drejtësisë, të menaxhimit të...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Për menaxhimin e çështjeve.

Prandaj, duhet të parashikojmë që të jetë një organ ose një institucion më vete, që do të menaxhojë gjithë këtë sistemin e menaxhimit të çështjeve, për të cilat Këshilli i Ministrave duhet të hartojë rregullat e përgjithshme.

Duhet të parashikojmë gjithashtu, se kjo qendër e përbashkët për zgjidhjen e çështjeve të IT-së. Duhet ta rregullojmë me ligj, që pushteti legjislativ dhe ekzekutiv të mos kenë akses në këtë sistem të menaxhimit. Do të jetë vetëm inspektorati i lartë ai që do të ketë akses në këtë sistem për zgjidhjen e çështjeve të IT-së, kuptohet, këto rregullore me ligjin e IT-së.

Çështja qëndron nëse Inspektorati i Lartë i Drejtësisë do të jetë organi ku mund të vendoset ky sistem për zgjidhjen e çështjeve të IT-së.

Ky organ do të jetë organi i vetëm që do të komandojë ose do të ketë akses në të gjitha sistemet e IT-së të organeve të tjera të drejtësisë.

**Fatmir Xhafaj** – Ideja juaj duket racionale. Duket ide që synon më shumë eficiencë në këtë aspekt të sistemit, por unë, besoj edhe kolegët, por unë jam pak i dyzuar, sepse këto janë propozime që janë bërë në tavolinë. Pa e parë një gjë qartë dhe pa e konsultuar, është e vështirë ta pranojmë, sepse mund ta kolapsojmë sistemin në qoftë se ne vëmë një qendër sot, ndërkohë që sistemi sot ka disa mënyra të menaxhimit. Vetë sistemi gjyqësor ka dy sisteme që konkurrojnë me njëri-tjetrin. Kështu që bëni një formulim që, provizorisht, sistemi të vazhdojë kështu siç është, deri në ngritjen e një qendre. Pastaj ligji ta përcaktojë, kur të vijë momenti, sepse ajo duhet programuar, duhet konceptuar. Pra, të synohet ë të ketë një qendër të unifikuar, por në një kohë të dytë, sepse nuk mund të fillojmë menjëherë me ligjin që ta unifikojmë këtë me një qendër të informacionit e të teknologjisë, që të fillojë menjëherë kjo, sepse mund ta kolapsojë sistemin.

Kështu që bëni një formulim, që të jemi të qartë dhe ta diskutojmë këtë gjë. Vetëm mos e vononi, sepse nuk ka kohë, pasi ligji do të mbyllet shpejt. Kemi lënë tri-katër dispozita të



hapura. Po kjo është temë në të cilën ne nuk jemi edhe kompetentë, për hir të së vërtetës, kështu që do të duhet ta diskutojmë një çikë edhe me Ministrinë e Teknologjisë e të Informacionit dhe Ministrinë e Drejtësisë.

Po.

**Ulsi Manja** – Ta heqim këtë merak. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është organi përgjegjës për kontrollin dhe shkeljet disiplinore për gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve.

Ne kemi hequr kontrollin e brendshëm dhe tani kemi lënë një inspektor.

**Fatmir Xhafaj** – Po.

**Ulsi Manja**– Ideja është kjo: dakord që Këshilli i Lartë i Prokurorisë mund ta vërë në lëvizje inspektoratin në lidhje me shkelje e të gjitha këto.

**Fatmir Xhafaj** – Po.

**Ulsi Manja**– Pyetja jonë është më konkrete: një qytetar që do t'i drejtohet me kërkesë të drejtpërdrejt Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për zvarritjen e hetimit, një subjekt, subjekt i procedimit penal. A mundet Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në këtë fazë të hetimit? Se çështja mund të jetë në hetime paraprake, por i zvarrit hetimet përmbi gjashtë muaj. Ose mund të jetë në gjykim.

A mundet Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ta ushtrojë kontrollin drejtpërsëdrejti, mbi kërkesë-ankesën e një subjekti të procedimit? Dakord kur e vë në lëvizje Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Jam dakord këtu.

**Fatmir Xhafaj** – Ai nuk vihet në lëvizje vetëm me dy këshilla, por edhe nga qytetarët, e dhe nga institucionet.

**Ulsi Manja**– Pikërisht, edhe nga qytetarët.

Po marrim rastin e një avokati, të një subjekti të procedimit. Ankohet sepse prokurori i çështjes zvarrit hetimet ose sepse gjyqtari zvarrit gjykimin. A mundet Inspektori i Lartë i Drejtësisë të vihet në lëvizje në këtë lloj forme, në këtë fazë të hetimit apo gjykimit?

**Agnes Bernhard** –(flet përkthyesi) Këto aspekte rregullohen te ligji “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”. Ne kemi këtu dy shkaqe për të marrë ose për të filluar hetime administrative, duke pasur parasysh e një ankesë mund të bëhet nga një avokat apo ndonjë qytetar.

E dyta, me iniciativën e tyre. Ndoshta duke marrë një lajm edhe nga media, inspektorati mund të fillojë vetë një hetim mbi çështjen.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 127. Dakord?

Neni 128: “Funkcionet dhe përgjegjësitë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”. Dakord?  
Me këto dy ndryshimet redaktoriale, neni 129. dakord? Me ndryshime të natyrës redaktoriale. Në rregull.

Neni 130: “Përbërja, mandati i anëtarëve dhe zëvendësimi”.

**Vasilika Hysi** – Zoti kryetar, është e nevojshme të theksohet ajo që thuhet në Kushtetutë, që anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi qëndrojnë në detyrë për një vit nga data e zgjedhjes së tyre.

**Fatmir Xhafaj** – Po.

**Vasilika Hysi** – Në rast pamundësie os konflikti interesi, anëtari zëvendësohet nga anëtari zëvendësues.

**Fatmir Xhafaj** – Më falni, po këtu te neni 129 hiqeni këtë: “selia, koha e takimeve dhe mbështetja administrative”.

Koha e takimeve...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në rregull.

Neni 130: “Përbërja, mandati i anëtarëve dhe zëvendësimi”, me ndryshimet që propozoi zonja Hysi. Dakord?

Neni 131: “Kushtet dhe kriteret për t’u përfshirë në shortin për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit dhe procedurat e përzgjedhjes”.

Dakord me ndryshimet e paraqitura?

Po.

**Agnes Bernhard** *–(flet përkthyesi)* – Opozita këtu ka një amendim, ku thotë se “mandati duhet të fillojë më datën 1 janar të çdo viti” dhe kjo është në përputhje me nenin 148, nëse s’e kam gabim, të Kushtetutës.

**Fatmir Xhafaj** – Ka të drejtë opozita. Dakord. edhe ne jemi dakord.

Në rregull. Tjetër? Me ndryshimet e paraqitura, përfshi edhe këtë që u theksua këtu...

**Vasilika Hysi** – Zoti kryetar, është reflektuar komplet ndryshimi kushtetues, prandaj ka shumë ndryshime në të gjithë paragrafët. Është ndryshimi që u bë pas marrëveshjes së 21 korrikut.

Më fal, roli i avokatit është në fund.

*(Ndërpreje e shkurtër incizimi)*

Dakord atëherë me 131-shin, me gjithë këto ndryshimet e paraqitura.

Ju lutem e të gjitha këto, te ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit, duhet të vendosim formulimin. Te të gjitha. Dakord?

*(Ndërpreje e shkurtër incizimi)*

Neni 132: “Detyrimi për të deklaruar konfliktin e interesit”. Dakord?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Pandeli Majko** – Domethënë shikoj nenet në vazhdim, edhe 132-shin, edhe 133-shi, edhe neni 14. Pse duhet ta themi qëllimin e nenit që në titull. Është konflikt interesi dhe pastaj vazhdon e zërthehet...

**Fatmir Xhafaj** – Papajtueshmëria. Më thjesht një çikë.

**Pandeli Majko** – Papajtueshmëria për shkak të lidhjeve familjare, po themi. Pse duhet të shtojmë edhe “gjinia ose krushqia”. Ju lutem!

Do të shikohet në media kjo dhe do të plasë gallata.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull, në rregull! Shumë faleminderit për interpretimin tuaj!

Neni 132.

**Pandeli Majko** – Edhe kjo “heqja dorë”. Domethënë te neni 134. Shikojeni pak titullin! Megjithëse e themi edhe në vijim.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 132. Dakord me ndryshimin e titullit?

Neni 133: “Papajtueshmëria”. Dakord?

Neni 134: “Heqja dorë”. Dakord?

Neni 135: “Përrjashtimi dhe zëvendësimi i anëtarit”. Dakord me saktësimin e bërë?

Neni 136: “Kryetari”.

Pika “d”...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Vasilika Hysi** – Mendoj se duhet të ketë një shtesë, zoti kryetar, në pikën “d”. Zgjedhja e kryetarit duhet të ketë transparencë. Pra, mbledhja e këshillit duhet regjistruar në sistemin audio dhe të ketë një përmbledhje të procesverbalit të mbledhjes së këshillit, që duhet mbajtur dhe duhet bërë publik në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë. përmbledhja e procesverbalit i vihet në dispozicion anëtarëve të këshillit, përpara se ajo të bëhet publike. në rast se ndonjëri prej anëtarëve ka dyshime për saktësinë e përmbledhjes së procesverbalit, kryetari i këshillit

organizon ballafaqimin e përmbledhjes me regjistrimin audio. Në qoftë se dyshimi i anëtarit rezulton i justifikuar, bëhet dhe ndryshimi. Këtë e vendosëm, nëse ju kujtohet, te mbledhjet e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Gjithashtu, vetë kryetari i këshillit ka përgjegjësi që të sigurojë dokumentacionin e mbledhjes së këshillit dhe mbajtjen e dokumentacionit në përputhje me legjislacionin për arkivat. Ai është përgjegjës, pra nënshkruan aktet e verifikimit, vlerësimit dhe renditjes, dhe ia përcjell ato organit të emërtesës.

Pra nuk është gjetur si duhet rregullimi, se kush i përcjell këto propozime për listimin e kandidatëve.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord me ndryshimet? Dakord! Faleminderit!

Neni 137: “Zëvendëskryetari”. Dakord? E kemi përcaktuar: “më i vjetri në moshë”. Në rregull!

Neni 138: “Relatori”. Janë disa saktësime. Dakord?

Neni 139: “Mënyra e ushtrimit të veprimtarisë dhe vendimmarrjes”. Sa veta janë?

*(Ndërprerje e shkurtër incizimi)*

Po, dakord!

**Vasilika Hysi** – Në fakt, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi është një institucion shumë i rëndësishëm kushtetues, mënyra e funksionimit të të cilit ka gjetur rregullim vetëm në një nen, në nenin 139. Ndërkohë që për institucionet e tjera ka një rregullim të detajuar të veprimtarisë dhe kompetencave të tyre, këtu ka vetëm një nen. Kolegët e opozitës kanë kërkuar për ta detajuar dhe kanë sjellë disa anë procedurale, të cilat mund të merren në konsideratë, sepse flitet për mënyrën se si operon, si e ushtron veprimtarinë dhe vendimmarrjen.

**Fatmir Xhafaj** – A mund t’i rishikoni këto, nëse ka elementë, që ta detajojë procesin e ta bëjë më të qartë? Dakord? Dakord zoti Brahimi?

Faleminderit për mirëkuptimin!

Neni 139 për t’u saktësuar dhe për t’u zgjeruar sipas propozimeve që e ka sjellë edhe opozita, ato që do të çmohen të arsyeshme, që janë komplementare, për qëllimin e dispozitës.

Neni 140: “Personeli administrativ”. Dakord?

Neni 141: “Regjistri zyrtar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”. Dakord?

Neni 142: “Publikimi i akteve”, me ndryshimet e bëra. Dakord?

Neni 143: “Sistemi i menaxhimit”.

Hiqeni këtë tani: Sistemi i menaxhimit. Përmbliidheni te këto lart, te aktet. Ose te regjistri.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ma shpjego një çikë, meqenëse ke pyetur.

**Vasilika Hysi** – Lidhur me këtë nen kam kërkuar sqarime dhe qartësime se për çfarë bëhet fjalë. Bëhet fjalë për kandidatë që aplikojnë për një pozicion...

**Fatmir Xhafaj** – Po është e thjeshtë fare. Për atë, për çfarë? Për çështje gjyqësore?

**Vasilika Hysi** – Të dhënat dhe gjithë dosjet e tyre, a duhet të kenë një rregull se si duhen menaxhuar? Duhet menaxhuar.

**Fatmir Xhafaj** – Po mirë, pra, vendosini në një nen më vete.

**Vasilika Hysi** – Pyetja që kam për ekspertët, që kam parashtruar edhe herën e parë, është: do të jetë elektronike? Do të mbahen elektronikisht edhe në *hard copy*, apo...

**Fatmir Xhafaj** – Aty ku thuhet “Administrata” mbahen edhe këto gjëra. Kaq. Dhe mbylleni këtë histori tashti, se po e bëni ligjin shto ujë e shto miell, sikur është rregullore. Nga ana tjetër kemi thënë që këshilli të bëjë një rregullore. Të vendoset aty, në rregullore. Pse, çfarë ka? Do të zihen për dosjen këta?

**Vasilika Hysi** – Atëherë si do ta lëmë për këtë?

**Fatmir Xhafaj** – Nuk duhet hequr fare, se s’ka kuptim. Te pjesa e administratës le të caktohet se si mbahet edhe arkivi.

Neni 144: “Transparenca”.

Tani s’e kuptoj këtë: “mbledhjet e këshillit janë të hapura”. Pastaj: “këshilli komunikon me publikun pas çdo mbledhjeje, përmes një komunikate për medien”.

A mund të na e sqaroni ju se ç’do të thoni më këtë? Edhe të hapura, edhe...

**Gent Ibrahimi**– Besoj se qëndrojnë që të dyja këto. Të hapura për ata të interesuarit, ndërsa për pjesën tjetër të publikut një komunikim i përmbledhur.

**Fatmir Xhafaj** – Ata do të kenë një diskutim të brendshëm midis tyre, për kandidaturat, për kriteret?

**Gent Ibrahimi** – Ju shqetëson fakti që janë të hapura? Mendoni se është më e përshtatshme të jenë të mbyllura?

**Fatmir Xhafaj** – Deri sa të bëhet procesverbali, të bëhet audio e të gjitha. Ata mund të kenë vëzhgues, po. Jam dakord që, siç e caktuat javën e kaluar nga Komisioni i Ligjeve, nga opozita dhe maxhoranca, dhe subjektet e interesuara mund të jenë vëzhgues.

**Gent Ibrahim** – Atëherë jo të hapura, por me vëzhgues institucionalë, të themi.

**Fatmir Xhafaj** – Patjetër!

Sepse do të kenë një diskutim të brendshëm ata. Mund të ketë gjëra që mund të diskutohen në mënyrë të brendshme, që pse nuk i plotëson këto kritere, apo mund të kenë dokumente që u kanë ardhur, të cilat do të kenë një proces, që janë konfidenciale. Janë të dhëna sensitive, për shembull, apo të dhëna personale.

Është diskutim pak delikat. Nuk e bëni në asnjë rast tjetër këtë gjë. përse duhet ta bëni? Dakord? në rregull.

Në të gjitha këto të kenë akses institucionet që kanë... të ketë të paktën opozita. edhe maxhoranca. Të kenë nga një përfaqësues Komisioni i Ligjeve; të ketë ndonjë përfaqësues Kuvendi, kuptohet përmes Komisionit të Ligjeve përfaqësohet, sepse ata e bëjnë pastaj edhe procesin e transparencës. Ata e bëjnë edhe shqyrtimin e kandidaturave këtu, kur vendos Kuvendi: te rasti i kryeinspektorit, te Gjykata Kushtetuese e me radhë. Por edhe Gjykata Kushtetuese, se emërimi vjen nga Presidenti, mund të caktojë një njeri. megjithëse ajo ka anëtarë vetë. Përfaqësohet.

Neni 144. Dakord me ndryshimet.

Neni 145: “Subjektet që vënë në lëvizje Këshillin e Emërimeve në Drejtësi”.

**Vasilika Hysi** – Mendoj se duhet vënë një kokë në fillim. Subjektet që e vënë në lëvizje, në bazë të Kushtetutës, janë: “Presidenti, kryetari i Kuvendit, kryetari i Gjykatës së Lartë” pastaj të fillojmë t’i sqarojmë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, fjalja këtu fillon direkt, sepse Presidenti dërgon listën e plotë të kandidatëve. Në radhë të parë cilat janë subjektet që vënë në lëvizje Këshillin e Emërimeve në Drejtësi? Është Presidenti, është kryetari i Kuvendit...

**Fatmir Xhafaj** – Po sa të shtosh një paragraf, i ke të parashtruara në përmbajtje dhe strukturë. Nuk ndryshon ndonjë gjë.

**Vasilika Hysi** – Në rregull!

**Fatmir Xhafaj** – Të prish punë thelbi?

**Vasilika Hysi** – Jo.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull!

Neni 145, me togfjalëshin: “së bashku me dokumentacionin e paraqitur”.

Dakord?

Po.

**Vexhi Muçmataj** – Te ky nen pse ka një diferencë midis kandidatëve për Gjykatën Kushtetuese dhe kandidatëve për Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë? Pse ka një diferencë në mënyrën e propozimit, të subjekteve që i propozojnë?

**Fatmir Xhafaj** – Sepse për inspektor shkohet vetë, drejtpërsëdrejti. Si të themi, janë me vetëkandidim.

**Vexhi Muçmataj** - E kuptoj, po përse duhet të jetë kjo diferencë?

**Fatmir Xhafaj** – Po kështu e ka Kushtetuta.

**Vexhi Muçmataj** – Në rast se është dispozitë kushtetuese...

**Fatmir Xhafaj** – Po, po!

**Gent Ibrahim** – Kjo është radha e veprimeve, sipas Kushtetutës. Në qoftë se do të bëhesh gjyqtar iu Gjykatës Kushtetuese, nga ai grupi që emëron Presidenti, në fillim do të aplikosh te Presidenti, dhe pastaj Presidenti e çon dosjen tënde te... Po në rast se do të aplikosh për inspektor, shkon drejtpërdrejt te Këshilli i Emërimeve.

**Vexhi Muçmataj** - Unë them: pse kjo diferencë midis tyre, kur ata janë vlerësuar pothuajse në një rang.

**Gent Ibrahim** – Si rezultat i rregullimit në ndryshimin kushtetues. Është e detyruar, në njëfarë mënyre.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull! Dakord me ndryshimet!

Neni 146: “Deklarimet e kontrollit të pasurisë të kandidatëve”.

Dakord.

Neni 147: “Deklarimi dhe kontrolli i rekordeve penale të kandidatëve”.

Dakord!

Neni 148: “Deklarimi dhe kontrolli i kushteve të tjera ligjore”.

**Vasilika Hysi** – ...ka sjellë dy formulime.

**Fatmir Xhafaj** – Po, janë këtu dy nenet që kemi mbi tryezë: “Deklarimi dhe kontrolli i kushteve të tjera ligjore” dhe ankimet kundër vendimeve për ndalimin e kandidimit. Janë të dyja nene të reja, që i keni në tryezë. Dakord?

Dakord! Faleminderit!

Neni 150: “Fillimi e afatet për zhvillimin e procedurës së vlerësimit dhe i renditjes së kandidatëve”.

Dakord me ndryshimet?

Dakord! Faleminderit!

Neni 151: “Kritere profesionale dhe morale për renditjen e kandidatëve”.

**Vasilika Hysi** – Zoti kryetar, ky është diskutimi që nisëm më parë, lidhur me kriteret që do të plotësojnë edhe kandidatët për inspektorë, po dhe çdo kandidat tjetër.

Sugjerimi i ekspertëve është që në këto nene, këto kritere duhet të vlejnjë edhe për kandidatët, të cilët do të kandidojnë për inspektorë të përgjithshëm. Nëse lexojmë kriteret e përcaktuara në nenin 151, këto kritere janë shumë të përgjithshme dhe është e vështirësisht të matshme. Sepse thuhet: “Vlerësohet rëndësia...”

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, dakord!

Kemi propozime shtesë?

**Vasilika Hysi** – Unë do të kërkoja nga ekspertët për t’i bërë më të matshme.

**Fatmir Xhafaj** – A keni ju ndonjë propozim?

**Vasilika Hysi** – Unë e kam kërkuar edhe herën e parë që të riformulohet. Unë nuk kam.

**Fatmir Xhafaj** – Keni ndonjë sugjerim?

**Vasilika Hysi** – kam kërkuar që të mos jenë kaq të përgjithshme.

**Fatmir Xhafaj** – Ata kaq kanë bërë!

Te propozimet e opozitës, a kishte?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, mund të merren edhe këto, edhe propozimet e zonjës Hysi. të reflektohen edhe ato të opozitës te ky nen, te neni 151. Dakord? I mbajtet shënim? Se s’kemi kohë të zbardhim procesverbalin, prandaj po insistoj për mbajtjen shënim, e për këtë ju kërkoj ndjesë! I bie që për zbardhjen e procesverbalit duhen ditë, ndërkohë që ne jemi në limite kohe, kështu që jeni të detyruar ta bëni këtë punë.

Në rregull! Dakord!



Neni 151 mbetet për t'u riparë, për t'u riformular edhe me propozimet që bëri zonja Hysi, të cilat janë paraqitur këtu me shkrim, e padyshim edhe ato që kanë sjellë me shkrim kolegët tanë të opozitës, pavarësisht se nuk janë prezent këtu.

Kreu V: “Përgjegjësia disiplinore e anëtarit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”.

Neni 152: “Rastet e përgjegjësive disiplinore të anëtarëve të këshillit”. Dakord? Sipas rregullave, procedurave të parashikuara në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”.

Neni 153: “Shkeljet disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit”, me redaktimet e bëra. Dakord?

Neni 154: “Statusi, autonomia dhe selia”. Dakord.

Neni 155: “Funksionet”. Dakord?

Neni 156: “Buxheti”, me ndryshimet e teknikës legjislative. Dakord.

Neni 157: “Organet drejtuese”. Dakord!

Neni 158: “Përbërja dhe mandati i anëtarëve të Këshillit Drejtues”, bashkë me sugjerimet që janë reflektuar. Dakord!

Neni 159: “Detyra, mbledhja, vendimmarrja e këshillit drejtues”. Dakord me ndryshimet. Kryesisht janë redaktime dhe teknikë legjislative. Është shtuar pika 4: “Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, rregullat dhe procedurat e organizuara në ligjin “Për veprimtarinë e organeve kolegjiale të organeve të administratës shtetërore dhe enteve publike zbatohen për organizimin e mbledhjeve, vendimmarrjen e këshillit të përgjithshëm drejtues të Shkollës së magjistraturës””.

Dakord me nenin 159, me shtesat?

Miratohet!

Neni 160: “Kushtet për emërimin e drejtorit”.

Dakord!

Neni 161: “Emërimi, statusi dhe qëndrimi në detyrë i drejtorit”.

Dakord me ndryshimet.

Po.

**Vasilika Hysi** – Ndjesë, por këtu te kushtet për emërimin e drejtorit të shkollës, po të shikoni pikën “c”, janë kritere jashtëzakonisht të larta.

**Fatmir Xhafaj** – S'ka pikë “c” këtu. ka 1, 2, 3, 4, 5.

**Vasilika Hysi** – Te pika 1, germa “c”. Te neni 160. Ndjesë që ju ktheva mbrapsht.

**Fatmir Xhafaj** – Po shumë mirë të jenë të larta. Të larta le të jenë kriteret.

**Vasilika Hysi** – S’besoj të ketë kaq shumë njerëz...

**Fatmir Xhafaj** – Aq sa ka.

**Vasilika Hysi** – Po mund të mos kesh fare.

**Fatmir Xhafaj** – Ka.

**Vasilika Hysi** – Profesor pesëmbëdhjetë vjet? Nga gjykata?

**Fatmir Xhafaj** – Këto kështu kanë qenë, nuk kanë lëvizur. Këto kanë qenë dhe janë.

S’do rrimë t’i hyjmë tani.

**Vasilika Hysi** – Në rregull!

**Fatmir Xhafaj** – Neni 161: “Emërimi, statusi dhe qëndrimi në detyrë i drejtorit”.

Dakord me ndryshimet e paraqitura!

Neni 162: “Detyrat”.

Dakord me redaktimet e bëra!

Neni 163: “Kushtet e largimit e largimit nga detyra të drejtorit”.

Dakord me ndryshimet e bëra!

Neni 164: “Përbërja dhe detyrat e këshillit pedagogjik”.

Dakord, pa ndryshime!

Neni 165: “Mbledhja dhe vendimmarrja e këshillit pedagogjik”. Ndryshimet e bëra me kuorumin, mënyrën e votimit, dhe pika 3 shtohet: “Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj i rregullave, procedurave, parashikuar në veprimtarinë e organeve kolegjiale, zbatohen dhe për organizimin e mbledhjeve të këshillit”.

Dakord me shtesat dhe ndryshimet!

Neni 166: “Përgjegjësia disiplinore. Drejtori i shkollës së magjistraturës, pedagogët e brendshëm dhe kandidatët për magjistratë mbajnë përgjegjësi për shkeljen disiplinore, në përputhje me këtë ligj dhe rregullat e brendshëm të shkollës”.

Dakord!

**Etilda Saliu**– Vetëm referencat duhen ndryshuar në këtë nen.

**Fatmir Xhafaj** – Urdhëro!

**Etilda Saliu**– Referencat te neni 167, referencat ligjore kanë një ndryshim.

**Fatmir Xhafaj** – Po, patjetër, se do të ndryshojë komplet ligji me këtë. dakord?

Dakord me referencat! Dakord me ndërhyrjen tuaj!

Neni 167: “Hetimi disiplinor...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Janë propozime që i keni: 167-ën, 168-ën, 169-ën. Propozime të reja. Siç i keni në tekst

Neni 170: “Shkelje disiplinore”.

Dakord, pa ndryshime!

Neni 171: “Masat disiplinore ndaj drejtorit ose pedagogëve”.

Dakord me këtë ndryshimin, përcaktimin e Gjykatës Administrative të shkallës së parë  
Tiranë?

Neni 172 “Masa disiplinore ndaj kandidatëve”.

Dakord?

Referencat?

**Etilda Saliu** – Jo vetëm referencat, por meqenëse projektligji “Për statusin e magjistratëve” dhe projektligji “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” nuk janë miratuar ende, ato dispozita mund ta ndryshojnë si numër, kështu që do t’i heqim dhe do t’u referohemi thjesht vetëm ligjit. Janë disa dispozita.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull! Është më e drejtë, më duket. Dakord!

Në lidhje me nenin 172, dakord me sugjerimin.

Neni 173: “Regjistrimi i konkurrentëve” me ndryshimet e bëra.

Dakord!

Neni 174. Me sugjerimet e bëra: “Programi i formimit fillestar”. Dakord!

Neni 175: “Zgjedhjet dhe emërimi i pedagogëve”.

Dakord me ndryshimin e bërë. Vetëm një ndryshim është.

Neni 176: “Pedagogë, gjyqtarë ose prokurorë...” Dakord me ndryshimet e teknikës  
legjislative.

177: “Konkurrimi dhe pranimi i kandidatëve”.

Me ndryshimet e paraqitura dhe që i keni përpara, dakord!

Neni 178: “Shpërblimi i magjistratëve për magjistratë”.

Dakord me këto ndryshimet, që janë të teknikës legjislative. Fjala “shpërblim” bëhet  
“bursë shkollimi”. Dakord!

Neni 179: “Vlerësimi i formimit fillestar për kandidatët magjistratë”.

Dakord, me një ndryshim të vogël te pika 6, që i takon teknikës legjislative.

Neni 180: “Vlerësimi i praktikës profesionale për kandidatët”.

Dakord me ndryshimin e bërë në pikën 1.

Neni 181: “Kategoritë e vlerësimit të kandidatëve për magjistratë”.

Dakord!

Neni 182: “Emërimi”. Me referencat te ligji “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”. Dakord!

Neni 183: “Formimi vazhdues”. Me ndryshimet e paraqitura, të cilat janë kryesisht saktësime te teknikës legjislative dhe redaktoriale. Dakord!

Neni 184: “Konkurrimi, formimi fillestar dhe vazhdues i avokatëve të shtetit”.

Dakord!

**Neni 185:** “Konkurrimi, formimi fillestar dhe vazhdues i këshilltarëve ligjorë të gjykatave dhe prokurorëve”. Me ndryshimet e bëra. Hiqen paragrafët 2, 3 dhe ngelet një paragraf i vetëm.

Dakord!

Neni 186 “Çdo ligj dhe akt nënligjor në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen”.

Pjesa 6, neni 187, “Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit. Dispozitat e fundit kalimtare. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

**Vasilika Hysi** – Zoti kryetar, lidhur me afatet, duhet të kemi kujdes te dispozitat kalimtare, pasi këtu ka disa dispozita, E para është për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor për krijimin Këshillit të Lartë.

**Fatmir Xhafaj** – Edhe kjo brenda një muaji nga hyrja në fuqi e ligjit, sepse nuk ka hyrë ende në fuqi ligji. Neni 107 “Dispozitat transitore, zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, pika 1, “Brenda një muaji nga hyrja në fuqi e ligjit për rivlerësimin”. Por një muaj, i bie që ai do të hyjë në fuqi dhe do të na ndodhë si... Të paktën bëjeni: “2 muaj” ose “brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji”.

**Vasilika Hysi** – Këto afate janë lënë sikur të shtatë ligjet do të kalonin bashkë me Kushtetutën. Tani të gjitha afatet duhen rishikuar.

**Fatmir Xhafaj** – Po, pra të gjitha afatet duhen riparë në këtë logjikë, se kemi bërë ndryshime. A keni ndonjë gjë tjetër për këtë nen? Jo.

Dakord.

Neni 188, “Krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Thamë që do të ndryshojmë afatet, sepse ka ndryshuar e gjithë logjika e afateve me miratimin e ligjit tjetër.

Shtohet pika 5, “Për transferimin e sistemeve të menaxhimit të çështjeve gjyqësore”. Mbasi është krijuar Këshilli i Lartë.

Neni 189, “Ngritja e strukturave administrative dhe organizimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Dakord me ndryshimin.

Neni 190, “Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, bëhet i replikueshëm. Ndoshta duhet sqaruar kjo si dispozitë.

Dakord.

Jo për aq sa është e mundur, mos të krijojmë probleme. Edhe “Krijimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë” është e plotë dispozita, jo me referencë. Dakord.

Neni 192, “Ngritja e strukturave administrative dhe organizative të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”. Dakord me ndryshimin e paraqitur dhe me ndryshimet e bëra në këtë nen.

Neni 193, “Zgjedhja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

**Vasilika Hysi** – Ka një detyrim për Këshillin e Ministrave në paragrafin e dytë, ku thuhet: “Brenda 5 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji ka krijuar të gjithë infrastrukturën për zhvillimin normal të veprimtarisë” e të tjera.

Në mbledhje ne e kemi lënë që duhet të pyetet Këshilli i Ministrave, sepse flitet për godinë, për pajisje. Në fakt, është pjesa e buxhetit tani. Është perioda prej 5 muajsh. A është e mundur?

**Fatmir Xhafaj** – Po, është e mundur.

**Vasilika Hysi** – Po, në rregull, nëse ju thoni se është e mundur.

**Fatmir Xhafaj**- Po sa e ka afatin maksimal, a e ka 8 muaj?

Lëreni 8 muaj për të dyja.

**Agnes Bernhard** – (*flet përkthyesi*) Është 8 muaj që nga hyrja në fuqi e Kushtetutës.

**Fatmir Xhafaj** – Po, pra, dakord. Atëherë, 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Dakord.

Dakord neni 192. E gjithë kjo duhet riformuluar atëherë me këto ndryshime.

Të gjithë këta që janë sot do të kalojnë automatikisht? Por ata mund të jenë inspektorët. Këshilli është i detyruar t'i mbajë këta? Duhet vendosur në të dyja këto se po të vijë Këshilli i Lartë Gjyqësor, do t'i rivlerësojë ata.

**Agnes Bernhard** – *(flet përkthyesi)* Inspektorët kanë një mandat të kufizuar 1-5 vjet.

Ligji për statusin e parashikon që inspektorët aktualë do të mbarojnë mandatin e tyre dhe pastaj, sipas ligjit, do të kthehen në pozicionet e mëparshme.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord. Po, ata mund të mos plotësojnë kriteret sipas ligjit të ri, atëherë nuk mund të qëndrojnë në detyrë, se nuk mund të kemi inspektorë me disa kriteret dhe inspektorë për shkak të ex officio. Kush plotëson kriteret, do të qëndrojë, sepse, meqenëse tani jemi në periudhë transitore, mund të bëhen emërimet të ndryshme, thjesht që të plotësohen vendet.

**Agnes Bernhard** – *(flet përkthyesi)* Ne duhet të sigurojmë që ky shërbim i inspektimit, edhe pse mund të funksionojë me një nivel të ulët, duhet të vazhdojë deri sa të...

**Fatmir Xhafaj**- Askush nuk e vë në diskutim, por qëndrimi në detyrë do të lidhet me krijimin e institucionit të ri, me plotësimin e kriterëve. Nëse nuk plotëson kriteret, ai nuk mund të vazhdojë, mund të qëndrojë në detyrë deri në momentin e zgjedhjes së Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, por në momentin që këto institucione të reja fillojnë dhe bëjnë rekrutimin e ekipeve të tyre, nuk mund të mbajnë njerëz, që nuk plotësojnë kriteret, sepse i bie që të kemi njerëz, për shembull, te rasti i inspektorit, me 3 standarde: magjistratë, inspektorë jomagjistratë, por që kanë kriteret, dhe inspektorë të trashëguar për shkak afati. Nëse ata mund të plotësojnë kriteret për inspektorë do të shkojnë në detyrat e mëparshme. Është e thjeshtë, nuk po them t'i lëmë pa punë, përkundrazi.

**Gent Ibrahimi**- Duke menduar që do të jetë mjaft i vështirë krijimi nga e para e këtij institucioni, një tranzicion na duket krejt i nevojshëm.

**Fatmir Xhafaj**- Jam shumë dakord.

**Gent Ibrahimi**- Mund t'i krijojmë ata edhe për një vit,

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, të paktën një vit deri sa ai bën vlerësimin. Nëse pastaj ai hyn në testim dhe ky nuk i rezulton, përse ta mbajë? U kuptuam? A jemi të qartë?

**Vasilika Hysi** – Unë mendoj që neni 193 duhet riformuluar edhe për shkak të afateve. Ka disa afate. Një afat lidhet me hyrjen në fuqi të ligjit të rivlerësimit. Ju thoni: “brenda një muaji nga hyrja në fuqi e ligjit të rivlerësimit”, sot skadoi afati, pra, ligji hyn për 15 ditë, “i

dorëzohet komisionit të pavarur të kualifikimit kush do të punojë si inspektor”, por komisioni nuk është ngritur ende. E para. Te paragrafi i parë.

Te paragrafi i dytë ju thoni: “Çdo jurist tjetër, i interesuar për pozicionin e inspektorit të lartë, brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji dorëzon aplikimin”. Po rivlerësimin kush do ta bëjë? Ai do të kalojë vetingun. Pra, si mundet pa filluar nga puna ngritja e hallkave që do të merren me vetingun, pavarësisht se Kushtetuta thotë që kanë përparësi, por ka rregulla, ka afate, apo jo? Ne themi që brenda 30 ditëve do të dorëzohet deklarata e pasurisë, 6 muaj kohë ka ILDKPI-ja, fillon vlerësimi i figurës, pra unë shikoj që afatet e përcaktuara në ligjin e vetingut dhe afatet që janë lënë tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk përputhen në këtë nen.

E treta, në paragrafin e tretë thuhet: “Në rast se kandidatët e parashikuar nuk lejohen të kandidojnë, në bazë të vendimit të shkallës së parë të komisionit të pavarur, ata konsiderohen të papërshtatshëm” dhe vazhdon fjalia më tej. Pra, edhe ky është një shqetësim, lidhur me afate, sepse duhet ngritur Këshilli i Emërimeve, duhet të ngrihen institucionet, do të fillojë vlerësimi.

E fundit që mua më duket më kontradiktorja, pasi të gjithë kandidatët e përshtatshëm kanë kaluar procesin e vlerësimit me vendim të Komisionit të Pavarur, komisioni njofton Këshillin e Emërimeve dhe i përcjell dosjen me qëllim kryerjen e vlerësimit.

Në katër paragrafë ka referenca në afate të ndryshme dhe në komisione që një pjesë nuk janë ngritur, dhe, nëse do të ngrihen, koha e ngritjes së tyre është në periudha të ndryshme, sepse ligjet nuk kanë kaluar të gjitha bashkë.

**Gent Ibrahimi-** Problemi i parë, që ka të bëjë me paragrafin e parë është fakti që referenca është te hyrja në fuqi e ligjit për rivlerësimin. Këtë problem mund ta zgjidhim nëse referencën e bëjmë te krijimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Pra të themi: “Brenda një muaji nga krijimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”.

**Fatmir Xhafaj** – Gjithsesi, hidhini një sy, të mos improvizojmë tani. Të jemi të kujdesshëm në afate, sepse ka të drejtë zonja Hysi. Kur janë bërë ligjet, është parashikuar të miratoheshin në një datë, menjëherë me miratimin e Kushtetutës. Koha ka kaluar. Ligji për vetingun ka kaluar përpara, ai sot hyn në fuqi, fillon afati 15 ditor i hyrjes në fuqi.

Dakord me nenin 193 me sugjerimet e bëra.

Neni 194 me ndryshimet e bëra dhe me sugjerimin për të riparë afatet, në dispropocionin e krijuar ndërmjet ligjeve dhe me ndryshimet e bëra te pika 1 dhe pika 8.

**Vasilika Hysi** – Neni 194 ka një mbivendosje me nenin 193, sepse te 193 ne themi: “Çdo jurist i interesuar për pozicionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë brenda dy muajve aplikon”, po dhe këtu thuhet: “brenda një muaji”. Tani a do të kemi një afat për krijimin e zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë? Afate të tjera do të lihen për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë?

**Fatmir Xhafaj** - Pse e lidhni me emërimin e tij?

Një muaj nga dita e emërimit.

**Vasilika Hysi** – Nga krijimi i Inspektoratit.

**Gent Ibrahim**- Neni 194 ka të bëjë me inspektorët e tjerë, ndërsa neni 193 me Inspektorin e Lartë.

Në rastin e dytë, si pikënisje është momenti i emërimit të Inspektorit të Lartë. Pra, një muaj nga momenti i emërimit të Inspektorit të Lartë.

**Vasilika Hysi** – Paragrafin e parë, të shtuar me të kuqe, ju e lidhni me momentin brenda një muaji nga hyrja në fuqi e ligjit të rivlerësimit. I bie që ju i emëroni më shpejt me këtë ligj inspektorët dhe më pas i lidhni me zgjedhjen e Inspektorit të Lartë, që ka afate të tjera.

**Gent Ibrahim** – Duke qenë se do të ketë kandidatë magjistratë, ata do të kalojnë si fillim nga vetingu dhe paragrafi i parë ka të bëjë me këtë situatë, ku një magjistrat sot, një gjyqtar, një prokuror, që do të aplikojë për pozicionin e inspektorit në Inspektoratin e Lartë, si fillim duhet të konsumojë vetingun.

**Fatmir Xhafaj** – Të paktën, lidhni me krijimin Komisionit të Pavarur.

**Gent Ibrahim**- Këtë do të bëjmë që ta lidhim jo me hyrjen në fuqi të ligjit të vetingut, por me planin e komisionit.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord me pikën 1, me pikën 8 me ndryshimet e bëra dhe në përgjithësi me afatet.

Dakord.

Neni 195, “Krijimi i Këshillit të Përkohshëm për emërimet në sistemin e drejtësisë”.

Dakord, me ndryshimet.

Neni 196, “Krijimi i Këshillit të Përhershëm të Emërimeve në Drejtësi”.

**Vasilika Hysi** – Te neni 195 është krijimi i Këshillit të Përkohshëm të Emërimeve në Drejtësi. Kjo nuk është ndryshuar, zoti kryetar. Kjo duhet të riformulohet komplet, sepse thuhet: “Brenda dy ditësh nga hyrja në fuqi e Kushtetutës”. Kushtetuta ka hyrë me kohë. Tani kjo nuk



duhet lidhur me ndryshimet kushtetuese, kjo duhet ndryshuar se nuk ka më kuptim, por nuk e di me cilin ligj do ta lidhim, sepse ne jemi në shkelje të Kushtetutës.

**Fatmir Xhafaj** – Për nenin 196?

**Vasilika Hysi** – Jo, për nenin 195, “Krijimi i Këshillit të Përkohshëm”.

**Fatmir Xhafaj** – Me atë do ta lidhim, Nuk e ndryshon dot .

**Vasilika Hysi** – Po Kushtetuta thotë: “Brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi”. Tani ne e kemi shkelur atë afat se nuk janë miratuar ligjet. Çfarë do të bëjmë?

**Fatmir Xhafaj** – Do ta lësh afatin, nuk ke si e bën ndryshe. Si do ta bësh? Do të shkelësh e Kushtetutën?

Hiqeni këtë “brenda dy ditësh nga hyrja në fuqi” “në përputhje me detyrimin kushtetues Prokurori i Përgjithshëm”... Më falni!

Për të rregulluar këtë handicap që është krijuar në këtë situatë, mund të themi: “Prokurori i Përgjithshëm, në përputhje me detyrimin kushtetues, harton një listë me emrat e të gjithë prokurorëve”, pa vënë afate, e lëmë evazive.

Neni 195, bëni një riformulim dhe flasim.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull 10-ta për t’u riformuluar siç e debatua.

Dakord?

Po kjo “Anëtarët e Këshillit të Emërimit të Drejtësisë zgjidhen në përputhje me nenin ... Llotaria hidhet në zyrën e Avokatit të Popullit”.

Duhet riformuluar pika 8, “Krijimi i Këshillit të Përkohshëm për ...” te neni 195.

Faleminderit për mirëkuptimin!

Neni 196, “Krijimi i këshillave të përhershëm të emërimeve në drejtësi”. Dakord?

Neni 197 do një emërtim dhe duhet thënë edhe përfshirja e përfaqësuesit të lartë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Prokurorisë në këshillin drejtues. Riformatim i këshillit.

Dakord.

Nenin 198. “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare”.

**Agnes Bernhard** – (*flet përkthyesi*) Në lidhje me nenin 197, duhet të përmendim 25 kandidatët që do të hyjnë në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2017-2018. Në ndarjen në profile në gjyqtarë e prokurorë duhet të jenë një numër i caktuar, 20, gjithmonë me një marrëveshje midis këshillave të Prokurorisë dhe Gjyqësorit.

**Fatmir Xhafaj** – Ka mundësi të vëmë këtu te dispozitat tranzitore që këshilli drejtues në bashkëpunim me ministrin e Drejtësisë, megjithëse ministri ka përfaqësuesit e vet në Këshillin e Drejtësisë, dhe Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe prokurorinë të përcaktojnë nevojat që do të jenë për vitin e ardhshëm? Të vëmë një dispozitë që të dimë, dakord për sivjet janë përcaktuar me ligj, por vitin që vjen...

**Agnes Bernhard** – *(flet përkthyesi)* E kemi këtë detyrim në ligjin e statusit.

**Fatmir Xhafaj** – Përderisa është në atë ligj, tërhiqem. Dakord.

Dakord me nenin 197 me riformulimin e propozuar nga zonja Bernhard.

Neni 198, “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare”.

E mbyllim këtu gjithë shqyrtimin e projektligjit.

E di që është një ligj i vështirë, shumë i vështirë nga pikëpamja e teknikës, por meritoni fjalët më të mira për këtë punë që keni bërë.

Ka mbetur edhe një hap tjetër për të reflektuar të gjitha ndryshimet që u propozuan dhe u ranë dakord.

Nesër në orën 12.00 duhet të jetë gati për t’u përfunduar.

Dakord në tërësi? Dakord.

E mbyllim.

Faleminderit të gjithëve për kontributin!

## **MBYLLET MBLEDHJA**

*Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga stafi teknik i angazhuar pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë*